

Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani”

Fakulteti i Filologjisë, Programi i Gjuhës Shqipe



Punim Diplome

Tema: Kontributi i Fadil Sulejmanit në fushën e gjuhës shqipe

Mentori:Kandidatja:

Prof.asc.dr. Xheladin ZymberajKaltrina Krelani

Gjakovë, 2017



Fadil Sulejmani

Abstrakt

Arsyeja e punimit të kësaj teme lidhet me kontributin e profesor Fadil Sulejmanit si gjuhëtar, studiues, profesor, dhe themelues i Universitetit të Tetovës, për gjuhën shqipe, ky punim është shtjelluar në formë hulumtuese, në të përfshihen biografia, veprat dhe veprimtaria e profesorit konkretisht vepra “Praktikumi i gjuhës shqipe” vështruar nga ana drejtshkrimore dhe drejtshqiptimore dhe “E Mbsuame e krështerë e Lekë Matrangës” e cila shërben për studimin historik të gjuhës dhe të letërsisë shqipe, si dhe përrolin e Fadil Sulejmanit për themelimin e Universitetit të Tetovës.

Fjalët kyçe: Fadil Sulejmani, Studiues, Universiteti, Veprat, Gjuha Shqipe

Abstract

The reason for this topic is related to the contribution of profesor Fadil Sulejmani as a linguist, scholar, professor and founder of the University of Tetovo for Albanian language, this topic is elaborated in a research form, including the biography, deeds and activities of the deceased concretely the work "Albanian Language Practice" by spelling and directional and "E Mbsuame e krështerë of Lekë Matranga " which serves for the historical study of Albanian language and literature as well as for the role of Fadil Sulejmani for the establishment of the University of Tetova.

Key words: Fadil Sulejmani, Scholar, University, Deeds, Albanian language

Përmbajta

Hyrje.....	5
Biografia.....	6
Praktikumi i Gjuhës Shqipe.....	9
Emri.....	9
Emrat e gjinisë mashkullore.....	10
Emrat mashkullore me temë me zanore.....	10
Emrat mashkullore me temë me –ë.....	10
Emrat mashkullore me temë me –i, -e, -u, -o dhe me –y.....	10
Emrat mashkullore me temë me –a.....	10
Emrat mashkullore me temë me togun zanor –ua.....	11
Emrat mashkullore me temë me bashkëtingllore.....	11
Emrat e gjinisë femërore me temë me –ë.....	11
Emrat e gjinisë femërore me temë me –e.....	12
Emrat e gjinisë femërore me temë me –i.....	12
Emrat e gjinisë femërore me temë me –a.....	12
Emrat e gjinisë femërore me temë me –o.....	13
Emrat e gjinisë femërore me temë me temë me bashkëtingllore.....	13
Dygjinia Mashkullore e femërore.....	13
Shumësi i parregullt mashkullore e femërorë.....	13
Mbiemri.....	14
Përemri.....	15

Përemri dëftor.....	15
Përemri vetvetor.....	15
Përemri pronor.....	15
Përemri pyetës.....	16
Përemrat e pacaktuar.....	16
Nyja.....	16
Numërori.....	17
Folja.....	17
Foljet ndihmëse <i>kam</i> dhe <i>jam</i>	17
Foljet gjysmëndihmëse <i>duhet</i> dhe <i>mund</i>	18
Foljet e parregullta dhe gjysmë të rregullta <i>vete</i> , <i>them</i> , <i>dua</i> , <i>jap</i> dhe <i>vij</i>	18
Paskajorja e tipit “ <i>për të larë</i> ”.....	19
Urdhërorja e tipit me trajta të shkurtra përemërore.....	19
Formimi i foljeve.....	19
Paraqitja me anë të tabelës të zgjedhimit të foljeve <i>kam</i> , <i>jam</i> , <i>zë</i> , <i>perzë</i> , <i>vë</i> , <i>nxë</i> . <i>lë</i>	20
Mënyra dëftore.....	21
Mënyra lidhore.....	22
Mënyra habitore.....	22
Mënyra dëshirore.....	23
Mënyra kushtore.....	23
Mënyra urdhërore.....	24
Format e pashtjelluara të foljes.....	24
Pjesët e pandryshueshme të ligjëratës.....	25
Ndajfolja.....	26

Parafjala.....	20
Lidhëza.....	20
Pjesëza.....	20
Pasthirrma.....	21
E Mbsuame e krështerë e Lekë Matrëngës.....	21
Shënime për jetën e autorit.....	22
Vepërza.....	22
Fletëkushtesa.....	23
Grafia.....	24
Gjuha.....	24
Fonetika.....	24
Vokalet.....	25
Theksi.....	25
Dukuritë fonetike.....	26
Elizioni.....	26
Asimilimi.....	26
Rotacizmi.....	26
Ortografia.....	27
Morfologjia.....	27
Emri.....	27
Mbiemri.....	27
Përemrat.....	28
Nyja.....	28
4.	
Numërori.....	28

Folja.....	28
Ndajfolja.....	29
Parafjala.....	29
Lidhëza.....	30
Pjesëza.....	30
Pasthirrma.....	30
Themelimi i Universitetit te Tetovës.....	30
Përmbledhje.....	36
Literatura.....	37
Jetëshkrimi.....	38

Hyrje

Fadil Sulejmani është një figurë e rëndësishme, ai ishte studiues, gjuhëtar, profesor, anëtar dhe rektor i parë i Universitetit të Tetovës. Hapja e Universitetit të Tetovës ishte hapi më i lavdishëm pas marrëveshjes së Ohrit, çka Maqedonëve nuk u pëlqeu aspak sepse edhe ata e kishin frikë altlerinë e shqiptarëve qoftë me dije qoftë me armë. Prof. Fadili ishte ndër ata burra që i doli ballë për ballë ushtrisë Maqedonase me slloganin e tij “Ne zgjodhëm rrugën e arsimit... duam lapsin dhe fletoren, nuk duam dhunë”. Profesor Fadil Sulejmani është autor i mbi 10 veprave shkencore dhe më tepër se 200 artikujve të publikuar në periodikë të ndryshëm dhe revista shkencore. Ndër veprat e tij më të rëndësishme janë: „E mbsuame e krështerë e Lekë Matrëngës”, një monografi për jetën dhe veprën e këtij autori arbëresh, Prishtinë 1979; „Praktikumi i Gjuhës së Sotme Shqipe”, Prishtinë 1981, shikuar nga aspekti drejtshkrimor dhe drejtshqiptimor etj. Profesor Fadil Sulejmani ka dhënë kontribut të rëndësishëm në fushën e Fonetikës dhe të Drejtshkrimit, në fushën e Gramatikës etj.

Fadil Sulejmani u lind në fshatin Bozovcë të Malësisë së Tetovës, më 5.12.1940. Arsimin fillor e kreu në vendlindje dhe në qytetin e Tetovës, kurse shkollën e mesme e kreu, me kurse private, po ashtu në Tetovë. Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prizren, ndërsa Fakultetin Filozofik, dega e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe e kreu në Prishtinë. Studimet pasuniversitare të magjistraturës i kreu në Beograd, kurse doktoroi në Universitetin e Prishtinës për shkencat filologjike. Ka punuar fillimisht si arsimtar i gjuhës dhe letërsisë shqipe në Obiliq të Prishtinës dhe 2 vjet punoi si profesor i gjuhës latine në Gjimnazin e Mitrovicës. Në vitin 1971 e filloi punën si mësimdhënës i rregullt i lëndëve Morfologji dhe Fonetikë e gjuhës shqipe në degën Gjuhë dhe Letërsi Shqipe të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës, ku punoi deri në vitin 1993, kur pushteti serb e pushtoi dhunshëm këtë universitet dhe disa institucione të tjera arsimore e shkencore të Kosovës. Në vitin 1995, Fadil Sulejmani u zgjodh e profesor i rregullt i shkencave filologjike po në këtë universitet. Gjatë kohës sa ishte mësimdhënës në Universitetin e Prishtinës, formimin e tij akademik e vijoi me 2 vjet specializim, si bursist i Fondacionit „Aleksandër Humboldt”, në Bon të Gjermanisë, si dhe 1 vit në Itali, që i mundësuan edhe njohjen e gjuhës gjermane dhe italiane, të cilat i shërbyen më vonë në hulumtimet e tij shkencore. Në vitin 1990, me fillimin e proceseve demokratike, u kthye nga Prishtina në qytetin e tij të lindjes, në Tetovë dhe u angazhua së bashku me intelektualë të tjerë dhe ish të burgosur e të përndjekur politikë në aksionin e madh popullor për pajtimin e gjaqeve. Në vitin 1990, me themelimin e Bashkësisë Kulturore Shqiptare në Maqedoni, me seli në Tetovë, Këshilli nismëtar ia besoi detyrën e Kryetarit të përkohshëm të kësaj organizate, të cilën e ushtroi deri në gusht të vitit 1991.¹Në vitin 1991, bashkë me punonjës të tjerë shkencorë, intelektualë dhe përfaqësues të asociacione shqiptare, u angazhua si anëtar i Këshillit organizues të Simpoziumit shkencor me karakter kombëtar „Shqiptarët e Maqedonisë”,

¹<https://shqipmedia.com/dy-vjet-pa-rektorin-e-pare-te-usht-se-prof-dr-fadil-sulejmani/>
Abdulla Mehmeti“ Dy vjet pa rektorin e parë të USHT-së, Prof. dr. Fadil Sulejmani”, 13.2.2015

i cili në aspektin e gjithanshëm shkencor e ndriçoi historinë e shqiptarëve dhe të këtyre trevave etnike nga lashtësia e hershme deri në ditët esotme. Më 1994, përkrah disa intelektualëve të tjerë, ka qenë njëri ndër nismëtarët për themelimin e Universitetit të Tetovës. Në Kuvendin themelues të këtij Universiteti, më 4 qershor, u emërua anëtar i Kryesisë së Universitetit, ndërsa më vonë, më 8 janar 1995 u zgjodh Rektor i Universitetit të Tetovës, detyrë që e ushtroi gjatë dy mandateve, deri në vitin 2002. Në ngjarjet më të rëndësishme të fillimit të punës së këtij Universiteti, Prof. dr. Fadil Sulejmani ishte në ballë të këtyre aktiviteteve si, në drejtimin e punës së organeve të përkohshme të Universitetit, në sjelljen e Vendimit për hapjen publike dhe fillimin e punës së Universitetit, më 15, 16 dhe 17 dhjetor 1994; në hapjen publike të vitit akademik 1994/1995, më 15 shkurt 1995, në Reçicë të Vogël; në fillimin e ligjëratave të para, në Poroj dhe Reçicë të Vogël, më 16 dhe 17 shkurt 1995; si dhe në aktivitete të tjera të cilat i vunë vulë arsimit universitar në gjuhën shqipe në Republikën e Maqedonisë. Për këto aktivitete, pushteti i asaj kohe në Maqedoni e ndoqi, e maltretoi shumë herë bashkë me familjen dhe e dënoi me 2 vjet heqje lirie, ndërsa dënimin me burg e vuajti në kohëzgjatje prej afër një viti. Profesor Fadil Sulejmani është nderuar me disa çmime nga Universiteti Shtetëror i Tetovës. Krahas titullit “Rektor Nderi i Universitetit të Tetovës”, akorduar nga Senati i këtij Universiteti, më 25 nëntor 2002, që u pasua edhe me çmimin “Nderi i Universitetit të Tetovës”, më 17 dhjetor 2002. Në 18 vjetorin e themelimit, më 17 dhjetor 2012, Universiteti Shtetëror i Tetovës, Rektorit të Parë, Prof. dr. Fadil Sulejmanit i ndau titullin: Doktor nderi i shkencave (Doctor honoris causa) i Universitetit Shtetëror të Tetovës. Profesor Fadil Sulejmani është autor i mbi 10 veprave shkencore dhe më tepër se 200 artikujve të publikuar në periodikë të ndryshëm dhe revista shkencore.²

²<https://shqipmedia.com/dy-vjet-pa-rektorin-e-pare-te-usht-se-prof-dr-fadil-sulejmani/>
Abdulla Mehmeti “Dy vjet pa rektorin e pare të USHT-së”, Prof. dr. Fadil Sulejmani, 13.2.2015

Ndër veprat e tij më të rëndësishme janë: „E mbsuame e krështerë e Lekë Matrëngës”, një monografi për jetën dhe veprën e këtij autori arbëresh, Prishtinë 1979; „Praktikumi i Gjuhës së Sotme Shqipe”, Prishtinë 1981, 1984; „Lindja, martesja dhe vdekja në Malësitë e Tetovës”, monografi për ritet familjare në këtë trevë; „Njohuri për Gjermaninë dhe popullin e saj”, 1995; „Fonetika e gjuhës gjermane”1995; “Morfologjia e gjuhës gjermane” 1995; „Hapi historik i universitetit tonë”, 1994. etj.Profesor Fadili ka lënë gati për shtyp disa libra, si: „E Folmja e Malësisë së Sharrit”, e cila ka qenë edhe temë e disertacionit të doktoratës së tij; „Toponimia e tri malësive të Tetovës”; „Lojërat popullore në Malësitë e Tetovës”; „Sintaksa e gjuhës gjermane” etj.Profesor Fadil Sulejmani ka dhënë kontribut të rëndësishëm në fushën e fonetikës dhe të drejtshkrimit, në fushën e gramatikës dhe të leksikologjisë, në fushën e dialektologjisë dhe të etnologjisë. Prof. dr. Fadil Sulejmani ndërroi jetë në orët e vona të ditës së diel, më 10 shkurt 2013, në Prishtinë, ndërsa u varros me nderime të larta si Rektor i parë i Universitetit Shtetëror të Tetovës, më 11 shkurt, në varrezat e qytetit të Tetovës.³

³<https://shqipmedia.com/dy-vjet-pa-rektorin-e-pare-te-usht-se-prof-dr-fadil-sulejmani/>
Abdulla Mehmeti “Dy vjet pa rektorin e pare të USHT-së, Prof. Dr. Fadil Sulejmani, 13.2.2015

Praktikumi i Gjuhës Shqipe

Praktikumi i gjuhës shqipe është shkruar duke u vështruar nga ana drejtshkrimore dhe drejtshqiptimore. Sipas autorit “ *Në shkrimet dhe në ligjërimet tona të përditshme të llojeve të ndryshme shpeshherë na bie rasti të dëgjojmë a të lexojmë fjalë të thëna a të shkruara me format e gabuara gramatikore, të cilat janë në kundërshtim me rregullat, me ligjet dhe me normën letrare të gjuhës së sotme shqipe. Si të tilla, ato e prishin dukshëm pastërtinë strukturore dhe qartësinë kuptimore e bukurinë natyrore të shprehjes së gjuhës sonë*”.⁴

Vepra “Praktikumi i gjuhës shqipe” ka njëmbëdhjetë kapituj gjashtë për pjesët e ndryshueshme të ligjëratës dhe pesë për pjesët e pandryshueshme. Sipas autorit “*Pjesët e ndryshueshme të ligjëratës siç dihet janë emri, mbiemri, përemri, nyja, numërori dhe folja. Në gjuhën e sotme letrare shqipe te pjesët e ndryshueshme të ligjëratës vërehen më shumë gabime drejtshkrimore sesa te pjesët e pandryshueshme. Që të thuhet e të shkruhet drejt këto pjesë të ligjëratës, d.m.th në pajtim me normën letrare, do të flitet për ato fjalë e për ato tipa fjalësh që paraqesin vështirësi më të mëdha drejtshkrimore dhe për ato trajta e për ato raste të përdorimit të tyre me gabime*”.⁵

Emri

Në shkrimet tona të përditshme të llojeve të ndryshme ndodh shpeshherë që në përdorimin e disa emrave të bëhen gabime në gjini, në numër, në rasë e në trajtë. Që të menjaherë këto gabime, do të flitet për ato raste të përdorimit të tyre ku gabohet më së shumti në të folur e në të shkruar.⁶

Emrat e gjinisë mashkullore

Emrat e gjinisë mashkullore mbarojnë përgjithësisht me temë mebashkëtingllore si shkop, mal, lis, gur, gëzof etj. por ka edhe një numër sish që dalin me temë me zanore.⁷

⁴ Fadil Sulejmani “Praktikumi i gjuhës shqipe”, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë 1981, f. 5.

⁵ Fadil Sulejmani “Praktikumi i gjuhës shqipe”, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë 1981, f.6

⁶ Fadil Sulejmani “Praktikumi i gjuhës shqipe”, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë 1981, f.9

⁷ Po aty

Emrat mashkullorë me temë me zanore

Njënumër i konsiderueshëm emrash të gjinisë mashkullore përfundojnë me temë me zanore të ndryshme si –ë, -e, -i, -a, -o, -y dhe me togun zanor ua. Përkundër emrave mashkullorë me temë me bashkëtingëllore, në përdorimin e emrave mashkullorë me temë me zanore më së shumti bëhen gabime. Pikërisht kjo është arsyeja që do të flitet kryesisht për këta emra.⁸

Emrat mashkullorë me temë me –ë

Emrat mashkullorë që mbarojnë me temë me –ë janë pothuajse të gjithë ata emra që tregojnë një tërësi lëndore të papërcaktuar si *ujë, dhallë, gjalpë, mjaltë, grurë* etj. Këta emra dikur janë përdorur me gjini asnjansë, kurse sot janë integruar në gjininë mashkullore, duke e formuar trajtën e shquar njejës të rasës emërore me mbaresën nyjore shquese –i (jo me atë –t, –të) si *ujë-uj, djathë-djathi, mjaltë-mjalti* etj Trajtat e numrit shumës i formojnë me mbaresën –ra.⁹

Emrat mashkullorë me temë me –i, -e, -u, -o dhe me –y

Emrat mashkullorë që mbarojnë me temë me zanoret –i, -e, -u, -o dhe –y janë të shumtë dhe të ndryshëm si *ulli, shalqi, kalli, flori, kushëri, turi, bri, gj, qiri* etj.; *pe, fre, dre, kacadre, hebre* etj.; *kërcu, hu, dru*, etj.; *hero; sy, dryetj*. Pjesa më e madhe e këtyre emrave në trajtën e shquar njejës në të gjitha rasat, duke marrë mbaresat përkatëse nyjore shquese, e zgjerojnë temën me një –r si *ulli- ulliri*, (i,e, të/prej) *ullirit, ullirin, kalliri, kushëriri, kufiri, hiri* etj.; ndërsa pjesa më e vogël e tyre e marrin mbaresën nyjore –u si *bari-bariu*(i, e, të/prej) *bariut, bariun*. Pothuajse të gjithë emrat e këtillë e formojnë trajtën e pashquar shumës me mbaresën -njsi *ulli-ullinj, kalli-kallinj, kërcu-kërcunj, hu-hunj, pe-penj, hebre-hebrenj* etj¹⁰

Emrat mashkullorë me temë me –a

Këta emra në pjesën më të madhe janë të burimit turk-arab, por ka edhe asish shqip si *aga, pasha, xhaxha, qehaja, budalla, fukara, qerrata, maskara, vëlla, ka, tra, va*. Emrat e këtij tipi me prejardhje turko-arabe në trajtën e shquar njejës të rasës emërore, gjinore, dhanore e rrjedhore e marrin mbaresën nyjore, përkatësisht rasore –i si *baba-babai*, (i, e, të/ prej) *babait*, kurse në kallzoren e shquar e marrin drejtpërdrejt nga tema e njejësit të pashquar mbaresën nyjore –në si *baba-babanë, aga-aganë, pasha-pashanë* etj. Disa emra të këtillë e formojnë numrin shumës me

⁸ Po aty

⁹ Fadil Sulejmani “Praktikumi i gjuhës shqipe”, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë 1981, f. 9-10

¹⁰ Fadil Sulejmani “Praktikumi i gjuhës shqipe”, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë 1981, f. 10-11

mbaresën –llarë: *baballarë-t, agallarë-t, pashallarë-t* , ndërsa disa të tjetërë me mbaresën –
*enjsibudalla-budallenj-të, qerrata-qerratenj-të, fukarenj-të, maskarenjtë.*¹¹

Emrat mashkullorë me temë me togun zanor –ua

Emrat që dalin me temë me togun zanor ua janë *thua, ftua, përrua, krua, lingua, dragua, potkua, fajkua* etj. Këta emra në trajtën e shquar njejës të rasës emërore, gjinore, dhanore e rrjedhore e mbledhin togun zanor ua në o si *thua-thoi*, (i, e, të/prej) *thoit; përrua-përroi*, (i, e, të/prej) *përroit* etj. Përrjashtim bëjnë emrat *përrua, krua*, dhe *zgjua*, që në shumësin e pashquar dalin me format *përrenj, krojedhe zgjoje* (por edhe *zgjoj*)¹²

Emrat mashkullorë me temë me bashkëtingllore

Emrat mashkullorë me temë me bashkëtingllore janë të shumtë dhe të ndryshëm për kah tingujt bashkëtingllorë që marrin në fund si *qumësht, koleg, detaj, kopsht, laps, etj.* Nga këta emra duhet dalluar veçmas ata që ndeshen më së shumti me gabime drejtshkrimore gjatë përdorimit të tyre në fjali siç janë: a) ata emra që e kanë njësoj njejësin me shumësin: *mësues-i-t, sulmues-i-t, dëgjues-i-t*, etj b) ata emra që pësojnë ndërrimin fonetik të palatalizimit si *mik-miq-të, fik-fiq-të, plak-pleq-të, zog-zogj-të, popull-popujt, kungull-kunguj-t* etj. c) ata që pësojnë ndërrimin fonetik të metafonisë si *dash-desh-të, cjap-cjep-të* ç) ata emra që formojnë shumësin me mbaresën –ërsi *prind –prindër-i-t, mbret –mbretër-i-t, kunat-kunetër-i-t, dreq-dreqër-i-t* etj¹³

Emrat e gjinisë femërore

Si emrat e gjinisë mashkullore, ashtu edhe ata të gjinisë femërore dalin me temë edhe me zanore edhe me bashkëtingëllore, por, derisa emrat mashkullorë përgjithësisht mbarojnë me bashkëtingëllore, ata femërorë përfundojnë me zanore.¹⁴

Emrat femërorë me temë me –ë

Emrat e gjinisë femërore që dalin me temë me –ë janë më të shumtë sesa ata që dalin me zanore të tjera si *mollë, vajzë, tubë, nënë* etj. Të gjithë këta emra në trajtën e shquar njejës emërore e bjerrin –ë në e temës dhe e marrin drejtpërdrejtë mbaresën nyjore-a p.sh. *mollë-molla, vajzë-vajza, nënë-nëna* etj. Përsa i përket numrit shumës, disa nga emrat e këtij tipi dëgjohen e shkruhen në jetën tonë të përditshme me një luhatje të konsiderueshme drejtshkrimore, duke u

¹¹ Fadil Sulejmani “Praktikumi i gjuhës shqipe”, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë 1981, f. 12

¹² Fadil Sulejmani “Praktikumi i gjuhës shqipe”, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë 1981 f. 13

¹³ Fadil Sulejmani “Praktikumi i gjuhës shqipe”, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë 1981 f. 13-14

¹⁴ Fadil Sulejmani “Praktikumi i gjuhës shqipe”, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë 1981 f. 14

përdorur herë me mbaresën –a e herë me atë –ë. Nga ata që paraqesin vështirësitë drejtshkrimore, duhet ta formojnë shumësin me mbaresën-a emrat *mënyrë, mënyra-t, klasë-klasa-t, detyrë-detyrat, vetë-veta-t* etj. Varësisht nga kuptimi i përdorimit, disa emra të këtij tipi në numrin shumës kanë nga dy trajta, me mbaresën –a dhe me atë –ë p.sh brinjë-brinja-t (e një vendi në mal a në bjeshkë) dhe brinjët (e trupit) Me këta emra shkojnë edhe emrat e përveçëm të gjinisë femërore të tipit *Dritë, Albanë, Diellë, Ajrinë, Dëshirë, Dhuratë* etj¹⁵

Emrat femërorë me temë me -e

Emrat e gjinisë femërore që mbarojnë me temë me –e janë dy farësh: a) emra femërorë me –e të patheksuar fundore si *lule, nuse, faqe, magje, katundare, fitore, hije, dritare, punishte* etj. b) emra femërorë me –e të theksuar fundore si *fe, re, be, kafe, ide, rrufe, klishe, hare, bufe* etj. me rëndësi drejtshkrimore për këta emra është se në trajtën e shquar njejës të rasës emërore e marrin në mes të temës dhe mbaresës nyjore –a tingullin eufonik –j- për çështje lehtëshqiptimi.¹⁶

Emrat femërorë me –i

Emrat femërorë që përfundojnë me temë me –i janë *liri, bukuri, shtëpi, dhi, dituri, veti, selvi, fjali, teori* etj. Mbarë emrat e këtij tipi në trajtën e pashquar dhe të shquar njejës i marrin drejtpërdrejt nga tema mbaresat rasore dhe nyjore pa ndërmjetësimin e tingullit eufonik –j- . Në rasat e zhdrejta të trajtës së pashquar e marrin mbaresën rasore –e- si (i, e, të/prej) një dhie, shtëpie, bukurie etj., kurse në trajtën e shquar e marrin mbaresën nyjore –së si (i, e, të/prej) një dhi-së, shtëpi-së, bukuri-së etj., dhe në rasat e drejta mbaresat nyjore –a për emëroren dhe –në për kallzoren si dhi-a./dhi-në, shtëpi-a/shtëpi-në, bukuri-a/bukuri-në etj.¹⁷

Emrat femërorë ne temë me –a

Këta emra, që e kanë pothuajse të gjithë të theksuar –a-në fundore, janë *mama, kinema, para, kala, shaka, bela, hata, sevda* etj. Siç mund të shihet nga këta shembuj, gati të gjithë këta emra janë me origjinë turko-arabe. Emrat e këtij lloji e marrin për lehtëshqiptim në mes temës dhe mbaresës rasore –e- tingullin eufonik –j- në trajtën e pashquar të rasave të zhdrejta (i, e të/prej) njëkala-j-e, një para-j-e etj si dhe në rasën emërore të trajtës së shquar në mes temës dhe mbaresës nyjore –a si kala-kala-j-a, mama-mama-j-a, para-para-ja etj.¹⁸

¹⁵ Fadil Sulejmani “Praktikumi i gjuhës shqipe”, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë 1981 f .14-15

¹⁶ Fadil Sulejmani “Praktikumi i gjuhës shqipe”, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë 1981 f . 16

¹⁷ Fadil Sulejmani “Praktikumi i gjuhës shqipe”, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë 1981 f .17

¹⁸ Fadil Sulejmani “Praktikumi i gjuhës shqipe”, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë 1981 f .17-18

Emrat femërorë me temë –o

Emrat e këitillë janë *pallto, radio, piano, çimento, balo, dado, pako, kosto, depo, xhiro, torno* etj. Me ndonjë perjashtim të rrallë (tablo, byro), pothuajse të gjithë këta emra zanorja fundore –o është e patheksuar. Si shumë emra të tjerë femërorë me temë me zanore, edhe emrat e këtij tipi e marrin për lehtë-shqiptim tingullin epentetik –j- në trajtën e shquar njejës të rasës emërore në mes të temës dhe mbaresës nyjore –a si *pallto-j-a, radio-j-a, depo-j-a* etj. dhe në trajtën e pashquar njejës të rasave të zhdrejta mes temës dhe mbaresës rasore -e- (i, e, të/prej) një *pallto-j-e, radio-j-e, depo-j-e* etj.¹⁹

Emrat femërorë me temë me bashkëtingllore

Njëpjesë e emrave të gjinisë femërore mbarojnë me temë me bashkëtinglloret –l,-r,-ll, dhe-z si a) me bashkëtinglloren –l: *vegël, gogël, pupël, thnegël, ashkël, bukël* etj.; b) me bashkëtinglloren –r: *zemër, vatër, letër, femër, hudhër, kodër, thupër, thembër, thundër, lundër, kthetër, flutur* etj.; c) Me –ll: *shpatull, ndrikull, sqetull, nofull, petull, sumbull* etj.; dhe ç) me konsunantin –z: *lidhëz, petëz, këmbëz, pjesëz, arkëz, mollëz, dregëz, vepërz* etj.

Dygjinia: Mashkullore e Femërore

Në lidhje me gjininë e disa emrave, që dikur, e për rrjedhim të kësaj edhe sot e gjithë ditën, janë përdorur e po përdoren herë me gjini mashkullore, herë me gjini asnjënjëse e herë me gjini femërore, në gjuhën e sotme letrare shqipe përdoren vetëm me gjini mashkullore emrat *nder-i; nderime-t, djep-i: djepa-t/dje-pet, ligj-i: ligje-t, sarkazmi: sarkazma-t, organizëm-organizmi: organizma-t, program-i: programe-t, gram-i: gramë-t, bust-i: buste-t, mjaltë-mjalti: mjaltëratetj.* dhe vetëm me gjini femërore emrat *pelenë-a, : pelena-t, benzinë-a, naftë-a.* Ndonjë emër përdoret me të njejtën formë herë si emër i gjinisë mashkullore dhe merr mbaresën nyjore –i e herë si emër i gjinisë femërore dhe merr mbaresën-(j)a si *stroofull-i : strofuj-t dhe strofulla: strofulla-t*²⁰

Shumësi i parregullt i emrave mashkullorë e femërorë

Disa emra të gjinisë mashkullore e femërore e formojnë shumësin në mënyrë disi të parregullt, duke e ndryshuar pak a shumë përbërjen fonetike të temave të tyre dhe kështu paraqesin vështirësi përdorimi në të folur e në të shkruar. Këta emra janë: të gjinisëmashkullore *vit, kalë, djalë, rreth, thes* dhe të gjinisë femërore *derë, dorë, grua, natë, gjë.* Nga emrat e përmendur të gjinisë mashkullore, emri *vit* në numrin shumës ka dy trajta: *vjet-vjetë-t* dhe *vite-t*. Trajta *vjet* përdoret edhe pas numërorëve themelorë edhe pas fjalëve që tregojnë sasi. Nga emrat e gjinisë femërore, emrat *derë e dorë* e formojnë shumësin duke i hapur zanoret e temës në togje zanoresh:

¹⁹ Fadil Sulejmani “Praktikumi i gjuhës shqipe”, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë 1981 f .18-19

²⁰ Fadil Sulejmani “Praktikumi i gjuhës shqipe”, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë 1981 f .20-21

e-në në ye dhe o-në në ua si *dyer-t dhe duar-t*, përkundrazi emri grua në numrin shumës e mbledh togun zanor ua nëa : *gra-të*. Ndërkaq, emri natë e bën shumësin me metafonizim të a-së së rrënjës nëe:*net-net-ët*, kurse emri *gjëduke* marrë mbaresën -ra:*gjëra-t*. Lidhur me shumësin e emrave po theksojmë se disa emra në shqipen e sotme letrare kanë dy forma gramatikore të numrit shumës si hamall-i: *hamajt-të*, bakall-i: *bakajt-të /bakejtë*, helli:*hejtë/heje-t*, ylli: *yjet/ yjtë*, dru – druri:*drurë-t/drunj-të*, gardhi-gardhe-t/*gjerdhet etj*²¹

Mbiemri

Në gjuhën e sotme letrare shqipe bëhen gabime drejtshkrimore edhe në përdorimin e disa mbiemrave tipash të ndryshëm si *i/e drejtë*, *i/e ftohtë*, *i/e çelët*, *i/e shurdhët*, *i (pa)sjellshëm* e *(pa)sjellshme*, *i përkohshëm*, e *përkohshme*, *i/e (pa) rregullt*, *i/e ditur*, *i/e lumtur*, *helmues-e etj*. Disa fjalë në gjuhën shqipe përdoren herë si mbiemra të nryshëm herë si ndajfolje. Kur përdoren si mbiemra, duhet të shkruhen me ë në fund si *i/e drejtë*, *i/e shpejtë*, *i/e plotë*, ndërsa kur përdoren si ndajfolje duhet të shkruhen pa -ë në fund si *drejt*, *shpejt*, *plot*,*fort*,*lart etj*. Edhe disa fjalë të tjera me rrënjë të përbashkët përdoren edhe si mbiemra të nryshëm edhe si ndajfolje dhe në të dy rastet duhet të shkruhen me –ë në fund pa dallim gjinie e numri si *i/e të mbarë—mbarë*, *i/e të prapë—prapë*, *i/e të mirë—mirë*, *i/e të rrallë—rrallëtj*. Vështruar në pikëpamje sintaksore, në të folur e në të shkruar të gjuhës së sotme letrare shqipe ndeshen shpeshherë përdorime të gabuara në lidhje me përshtatjen e mbiemrave me emrin dhe me rendin e tyre në një fjali si përcaktues të një gjymtyre të dhënë. Bie fjala, mbiemri që përcakton dy e më shumë gjymtyrë homogjene të një fjalie, përshtatet me atë gjymtyrë homogjene që i rri më afër, që e ka pranë si *Çdo kolektiv punonjës duhet ta çmojë e ta shpërblejëpunëtorin e punëtoren e zellshme*.²²

Përemri

Në lidhje me përemrat vetorë, vlen të theksohet që në fillim se si pas traditës sonë shkollore është bërë zakon që për përemrat vetorë të jepet një përkufizim i përgjithësuar se ata “janë fjalë që zënë vendin e një emri”. Ky është një definicionpjesërisht i gabuar, sepse punën e bëjnë vetëm përemrat vetorë të vetës së tretë, që me origjinë janë përemra dëftorë, por jo edhe përemrate vetës së parë e vetës së dytë. Bie fjala, shpeshherë gjatë të shkruarit e të folurit na bie puna që ta përdorim disaherë një emër në funksion të kryefjalës, të kallëzuesit emëror, të kundrinës, të ndajshimit, të plotësve të ndryshëm etj dhe me qëllim që t’i largohemipërsëritjes monotone të njëpasnjëshme të të njëjtit emër, rregullisht atë e zëvendësojmë me njërin nga përemrat vetorë të vetës së tretë në varësi me numrin dhe me gjininë e emrit të zëvendësuar.²³

²¹ Fadil Sulejmani “Praktikumi i gjuhës shqipe”, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë 1981 f .21

²² Fadil Sulejmani “Praktikumi i gjuhës shqipe”, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë 1981 f .37-62

²³ Fadil Sulejmani “Praktikumi i gjuhës shqipe”, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë 1981 f .65

Përemrat vetvetorë

Ky përemër s'ka forma të veçanta për të dalluar gjininë dhe numrin shumë. Ai përdoret në formën e një emri të gjinisë femërore të tipit *dele*. Duhet të përdoret në format vete-vetja (dhe jo: vehte-vehtja) dhe forma e bashkuar vetvete-vetvetja (dhe jo:vetvehte-vetvehtja as vetëvete-vetëvetja). Mund të përdoret pa dhe me parafjalë: Atij i ka hyrë**vetja** në qejf ; I ra prapa **vetes** ; E ka marrë**veten** në qafë; Askush s'e shan **vetvetenetj**. Ky vetvetor lakohet në trajtën e shquar njejës si emrat e gjinisë femërore me temë me –e si emërore : vetja/vetvetja; gjinore, dhanore e rrjedhore : (i,e/prej) vetes/vetvetes dhe kallëzore: veten/vetveten. I afërt me këtë vetvetor është përemri *vetë*, i cili përdoret për të përcaktuar apër të përforcuar kryefjalën si **Vetë unë** e pashë etj. Ky përemër duhet të shkruhet kurdoherë me *ë* në fund dhe pa *h*: vetë ai (dhe jo: vet as vehtë).²⁴

Përemrat dëftorë

Nga përemrat dëftorë që paraqesin rëndësi drejtshkrimore janë ata të tipit *i/e/të atillë, i/e/të këtillë, i/e/të tillë* etj., të cilët në të rastet e përdorimit duhet të shkruhen me *ë* në fund si në emërore: një djalë i atillë/I këtillë/I tillë, në gjinore në dhanore dhe në rrjedhore: (I,e/prej) një djali të atillë/ të këtillë/ të tillë dhe në kallëzore: një djalë të atillë/të këtillë/të tillë. Përkrah formave tërasës rrjedhore (*prej*) *këtij/këtij djali, (prej)kësaj/kësaj vajze* njejës dhe prej (*prej*) *këtyre/këtyre*, përdoren edhe format rasore të rrjedhores së vjetër : *kësi/kësi djali, asi/asi djali; këso/këso vajze, aso/aso vajze* njejës dhe *kësisht/kësi* djemsh, *asish/asi djemsh;kësosh/këso vajzash, asosh/aso vajzash*.

Përemrat pronorë

Përemrat pronorë si dhe shumica e përemrave të tjerë janë fjalë dëftuesë, që tregojnë pronarin e një prone të caktuar dhe kanë tri veta me nga dy numra, rasë e gjini e cila në vetën e parë dhe të dytë dallohet vetëm nga prona , kurse në vetën e tretë edhe nga prona edhe nga pronari. Këta mund të përdoren pa dhe me emra. Kur përdoren së bashku me emra luajnë rolin e një përcaktori, fjale përcaktuese, që sipas traditës sonë shkollore quhet mbiemër përcaktues, i cili me këtë rast duhet t'i përshtatet fjalës së përcaktuar në gjini, në rasë dhe në numër. Ndërsa kur përdoren pa emra, ata s'mund të qëndrojnë vetëm prandaj emërzohen dhe kryejnë funksionin sintaksor të një kallëzuesi emëror ose të një kryefjale dhe me këtë rast, përveç të tjerash duhet të marrin edhe kuptimin gramatikor të trajtës.²⁵

²⁴ Fadil Sulejmani "Praktikumi i gjuhës shqipe", Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë 1981 f .74

²⁵ Fadil Sulejmani "Praktikumi i gjuhës shqipe", Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë 1981 f .75

Përemrat pyetës

Përemrat pyetës që përdoren në gjuhët e sotme letrare shqipe janë fjalëst *kush? cili?*(*cila, cilat, cilët*), *ç'?*, *çfarë?*, *çka?*, *sa?*, *i sati?*, (*e sata?*, *të satat?*, *të satët?*), *me se* ,? *për se?*, *mbi se?*, *prej se?*, *mga se?*, *i, e, të sejtë?*.

Nga këta përemra, rëndësi drejtshkrimore paraqet më së shumti përemri *kush?*. Ky përemër kurrë nuk përdoret në bashkëvjajtje me emra dhe foljen e kërkon kurdoherë në numrin njejës si *Kush troket në derë* (*dhe jo: Kush njeri troket në derë?*); *Kush është ai atje* (dhe jo *kush njeri është atje?*). Përemri *kush* ? përdoret për të pyetur vetëm për njerëz: *kush e di mësimin nga ju?* Ky përemër nuk përdoret për të pyetur shtazë ose gjësende të ndryshme. Përemri ç' shkruhet kështu me apostrof. Përemrat *për se* ?, *me se?*, *mbi se?*, *prej se?* dhe *nga se?* duhet të shkruhen kështu në formë të ndarë. Ndërsa përemri pyetës *i, e, të sejtë* duhet të shkruhet më –ë në fund.²⁶

Përemrat e pacaktuar

Gabimet drejtshkrimore bëhen edhe në përdorimin e disa përemrave të pacaktuar, duke u shkruar herë me ë e herë pa të në fund ose në trup të tyre dhe herë në formë të ndarë e herë në formë të bashkuar. Shkruhen me ë në fund përemrat e pacaktuar gjithë, shumë, tërë, mbarë, gjë, një asnjë, njëfarë kurse pa –ë fundore shkruhen përemrat *tjetër-tjetri*, *plot*, *aq kaq*, *mjaft*, *pak*, *diç*. Shkruhen në formë të bashkuar, të përngjitur, dhe e ruajnë–ë- në e fjalëve gjë, një, farë e shumë, si pjesë përngjitëse të tyre, përemrat *asgjë*, *asgjësend*, *gjësend*, *gjëkafshë*, *asgjëkafshë*, *mosgjë, ndonjë*, *asndonjë*, *çfarëdo*, *çfarëdolloj*, *njëfarë*, *asnjëfarë*, *asnjëfarëlloj*, *shumë-kush*. Përkundrazi fjalët gjithë e kurrë, si pjesë përngjitëse të një emri të pacaktuar nuk e ruajnë –ë-në e trupit të tyre si *gjithkush*, *gjithsecili*, *gjithçka* etj. Lokucionet përemërore *nga sa* dhe *me sa* të formuar nga bashkimi i parafjalëve *nga* e *me* me përemrin lidhor të pacaktuar sa duhet të shkruhen kështu në formë të ndarë.²⁷

Nyja

Gjuha shqipe është e pasur ndër të tjera edhe me disa fjalëza shërbyese, që i shoqërojnë disa pjesë nominale të ligjëratës e që sipas traditës gramatikore është bërë zakon të quhen nyja. Shqipja ka tri palë këso fjalëzash, nyjash, që përbëjnë një pjesë të veçantë të ligjëratës. Këto janë: nyjat e caktuara ose shquese –i e –upër gjininë mashkullore, -a për gjininë femërore, t (ë) për gjininë asnjënëse dhe t (ë) për shumësin e tri gjinive si mal-i, shok-u, fushë-a, të kuq-të, të bardhë-t, miq-të sa njëqind të këqij etj. dhe nyjat e përparme i për gjininë mashkullore, e për

²⁶ Fadil Sulejmani “Praktikumi i gjuhës shqipe”, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë 1981 f.84

²⁷ Fadil Sulejmani “Praktikumi i gjuhës shqipe”, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë 1981 f.85

gjininë femërore, të (e) për gjininë asnjëse dhe të (e) për shumësin e tri gjinive i/e hollë, të zitë, të hollë/të holla/të hollat etj²⁸

Numërori

Në gjuhën e sotme letrare shqipe vërehen gabime drejtshkrimore edhe në përdorimin e disa numërorëve. Numërorët janë dy farësh : numërorë themelorë që tregojnë numra abstraktë ose sasi të caktuara frymorësh a sendesh dhe numërorë rreshtorë që tregojnë rreshtin a rradhën e frymorëve a të gjësendeve konkrete a abstrakte. Numërorët themelorë nuk e kanë të përcaktuar gjininë: ata përdoren me formë të njejtë, si atëherë kur e përcaktojnë një emër të gjinisë mashkullore, ashtu edhe atëherë kur e përcaktojnë një emër të gjinisë mashkullore a asnjëse p.sh Me **një** lule s’del pranvera. Ai ka **dhjetë** fëmijë etj. Në gjuhën e folur letrare numërori *dyduhet* të dallohet për kah shqiptimi kur tregon frymorë a gjësende të gjinisë mashkullore dhe atëherë kur tregon gjësende të gjinisë femërore. Kur tregon objekte e frymorë të gjinisë femërore duhet të shqiptohet me y të theksuar (të gjatë) edhe pse në gjuhën e shkruar nuk shënohet mbi të kurrfarë theksi grafik. Ndërsa kur tregon objekte e frymorë të gjinisë mashkullore shqiptohet me y të zakonshme.²⁹

Folja

Nëmesin e kategorive leksiko-gramatikore të gjuhës shqipe, folja është pjesë e zgjedhueshme e ligjëratës, e cila gjatë përdorimit të saj në fjali del me forma të shumta e të ndryshme gramatikore sipas mënyrës, kohës, vetës, numrit, diatezës etj³⁰

Foljet ndihmëse *kam* dhe *jam*

Këto folje shërbejnë për të zgjedhuar foljet e tjera në kohët e përbëra, analitike, të mënyrave të ndryshme. Folja *kam* ndihmon zgjedhimin e foljeve në diatezën veprorë: *kam larë*, kurse folja *jam* ndihmon në zgjedhimin e foljeve në diatezën pësore- vetvetore: *jam larë* etj.³¹

²⁸ Fadil Sulejmani “Praktikumi i gjuhës shqipe”, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë 1981 f.86

²⁹ Fadil Sulejmani “Praktikumi i gjuhës shqipe”, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë 1981 f.95

³⁰ Fadil Sulejmani “Praktikumi i gjuhës shqipe”, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë 1981 f.98

³¹ Po aty.

Foljet gjysmëndihmëse *duhet dhe mund*

Foljet *duhet* dhe *mund* quhen folje gjysmëndihmëse meqenëse shërbejnë për të zgjedhuar foljet e tjera jo në të gjitha mënyrat, kohët, vetat e numrat, por vetëm në mënyrën lidhore të kohës së tashme e të pakryer të vetës së tretë njejës dhe, ngase shprehin qëndrimin e folësit ndaj realitetit që ai ka, ai ka edhe folje modale, mënyrore. Në të folur e në të shkruar keto folje vijnë të përdorura para foljesh të tjera në mënyrën lidhore, duke shprehur folja *duhet* domosdoshmërinë a nevojshmërinë, kurse ajo *mund* mundësinë a lejushmërinë e kryerjes së veprimit nga vepruesi, kryefjala.³²

Foljet e parregullta dhe gjysmë të rregullta *vete, them, dua, jap dhe vij*.

Këto folje janë të parregullta (*jap, vij*), përkatësisht gjysmë të parregullta (*vete, dua, them*), duke qenë se kur përdoren në fjali pësojnë ndryshime të plota, përkatësisht të pjesshme në temat e veta. Edhe këto folje në të folur dhe në të shkruar të gjuhës sonë letrare me gabime drejtshkrimore. Që të shkruhen drejt e pa gabime në pajtim me normën letrare, do të shqyrtohet veç e veç secila nga këto folje. Folja *vete* në të tria vetat e numrit njejës të së tashmes dëftore e ka zgjeruar temën me rrokjen *-te* dhe del me këtë formë pa ndryshime si (*unë, ti, ai/ajo*) *vete*, kurse në numrin shumës i merr mbaresat vetore: *-mi* për veten e parë, *-ni* për vetën e dytë dhe *-nëpër* vetën e tretë si (*ne*)*vemi(ju) veni dhe (ata/ato) venë*. Në aorist del me format *vajta, vajte, vajti, njejës dhe vajtëm, vajtët, vajtën* shumës.³³ Folja *them* në të tashmen e dëftores përdoret me trajtat (*unë*) *them*, (*ti*) *thua* dhe (*ai/ajo*) *thotë*njejës dhe (*ne*)*themi, (ata/ato) thonë*në shumës. Në aorist bën: *thashë, the (<thae), (u)tha* njejës dhe *thamë, thatë, thanë*shumës. Folja *dua* në kohën e tashme të dëftores del me këtë formë në vetën e parë kurse në vetën e dytë e të tretë njejës e mbledh togun zanor *ua* nëo si (*ti, ai/ajo*) *do* dhe në numrin shumës del me format (*ne*)*duam, ju doni, (ata/ato) duan*. Në të kryerën e thjeshtëmerr format (*u*) *desha, (u)deshe, desh/ u desh njejës dhe (u) deshëm, (u)deshët, (u) deshën* shumës.

Folja *jap* në vetën e dytë dhe të tretë njejës dhe në vetën e dytë shumës të së tashmes dëftore e mefonizon *a-në* e temës nëe si (*unë*)*jap, (ti, ai/ajo) jep, (ju) jepni*. Kështu edhe në format joveprore : *jepem, jepesh* etj. Në aorist del me format (*u*) *dhashë, (u) dhamë, (u) dhanë* shumës. Folja *vij* si folje që tregon lëvizje të subjektit ka vetëm diatezën veprorë dhe në të tashmen e dëftores del me format (*unë*) *vij, (ti, ai/ajo) vjen* njejës dhe (*ne*)*vijmë, ju(vini), (ata/ato) vijnë* shumës. Në aorist del me formën *erdha*.³⁴

³² Fadil Sulejmani "Praktikumi i gjuhës shqipe", Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë 1981 f.99-100.

³³ Fadil Sulejmani "Praktikumi i gjuhës shqipe", Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë 1981 f.120.

³⁴ Fadil Sulejmani "Praktikumi i gjuhës shqipe", Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë 1981 f.120-122

Paskajorja e tipit “për të larë”

Në gjuhën e sotme letrare shqipe, sidomos në të folur, ndeshen gabime edhe në të folur edhe në përdorimin e paskajores së tipit “për të larë”. Kjo formë foljore e paskajores është formuar duke ia paravënë pjesëzën trajtëformuese për emrin foljor të gjinisë asnjane të *larë: për + të larë ~ për të larë*. Në vend të formës së pashtjelluar foljore *për të larë* që është normë letrare ndeshen të përdorura gabim format foljore *me la/me u la, për me la/për me u la, për të la/për t’u la, me mësuat/ me u mësuat, për me mësuat/ për me u mësuat, për të mësuat/për t’u mësuat* e kështu me radhë, që s’janë normë letrare.³⁵

Urdhërorja me trajta të shkurtra përemërore

Në gjuhën e sotme letrare shqipe të folur e të shkruar në tubime të ndryshme zyrtare e publike e nëpër gazeta, nëpër revista e nëpër libra të ndryshëm ndeshen gabime të shumta drejtshkrimore në përdorimin vend e pavend të trajtave të shkurtra përemërore pranë foljeve në mënyren urdhërore. Këto gabime vërehen më së shumti e janë më të mëdha kryesisht atëherë kur trajtat e shkurtra përemërore vijnë të përdorura pas foljeve të kësaj mënyre. Siç dihet, me folje të vetës së dytë njëjës e shumës të mënyrës urdhërore përdoren vetëm në trajtat e shkurtra të përemrave vetorë të vetës së parë dhe të vetës së tretë, kurse ato të vetës së dytë nuk përdoren, sepse ato në gjuhën shqipe në këto raste bëjnë punën e kryefjalës dhe të kundrinës së drejtë ose të zhdrejtë, por jo edhe të shërbejnë njëkohësisht si të tilla.³⁶

Formimi i foljeve

Foljet në gjuhën shqipe për kah burimi mund të jenë: a) fjalë të parme, që s’janë formuar nga fjalë të tjera me anë ndajshitesash (afiksesh) si *laj, lua-j, thye-j, kthe-j, fal, mat, jap, mjel* etj.; b) fjalë të prejardhura, që janë formuar nga fjalë të tjera me anë ndajshitesash të ndryshme si : *nder-o-j, dëm-to-j, vend-os, vlerës-o-j, dorëz-o-j, për-shëndet, stër-vjedh, ndër-marr* etj.; c) fjalë të përbëra, kompozita, që janë formuar nga bashkimi i dy a më shumë fjalëve të ndryshme si *bashkjetoj, duartrokas, parandiej, keqpërdor* etj. dhe ç) fjalë të përngjitura, që kanë dalë nga përngjitja e një togfjalëshi si *falenderoj* (nga falem nderit), *ngjatjetoj* (nga tungjatjeta < t’u ngjattë jeta), *bëzaj* (nga bë za), *vërej* (nga vë re), *shtozoj* (nga shto zot) etj.³⁷

³⁵ Fadil Sulejmani “Praktikumi i gjuhës shqipe”, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë 1981 f.122-123

³⁶ Fadil Sulejmani “Praktikumi i gjuhës shqipe”, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë 1981 f.124

³⁷ Fadil Sulejmani “Praktikumi i gjuhës shqipe”, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë 1981 f.127

Paraqitja me anë të tabelës të zgjedhimit të foljeve kam, jam, zë, përzë, vë nxë, lë.

Mënyra Dëftore

Tipi i foljes	kam	jam	zë, përzë	vë
E tashme	kam ke ka kemi keni kanë	jam je është jemi jeni janë	zë-zihem zë-zihesh zë zihet zëmë-zihemi zini-ziheni zënë-zihen	vë-vihem vë-vihesh vë-vihet vëmë-vihemi vini-viheni vënë-vihen
E pakryer	kisha kishe kishte kishim kishit kishin	isha ishe ishte ishim ishit ishin	zija-zihesha zije-ziheshe zinte-zihej zinim-ziheshim zinit-ziheshit zinin-ziheshin	vija-vihesha vije-viheshe vinte-vihej vinim-veheshim vinit-viheshit vinin-viheshin
E kryer e thjeshtë	pata pate pati patëm patët patën	qeshë qe qe qemë qetë qenë	u/zura u/zure zuri/ u zu u/zumë u/zutë u/zunë	u/vura u/vure vuri/ u vu u/vumë u/vutë u/vunë
E kryer	kam pasur	kam qenë	kam/jamë zënë	kam/jam vënë
E kryer e plotë	kisha pasur	kisha qenë	kisha/isha zënë	kisha/isha vënë
E kryer e tejshkuar	pata pasur	pata qenë	pata/qeshë zënë	pata/qeshë vënë
E ardhme	do të kem do të kesh do të ketë do të kemi do te keni do të kenë	do të jem do të jesh do të jetë do të jemi do të jeni do të jenë	do të zë ----- zihem do të zësh ----- zihesh do të zërë ----- zihet do të zëmë ----- zihemi do të zini ----- ziheni do të zënë ----- zihen	do të vë ----- vihem do të vësh -----vihesh do të vëmë ----- vihemi do të vini ----- viheni do të vini ----- viheni do të vënë ----- vihen

E ardhme e përparme	do të kem pasur	do të kem qenë	do të kem/jem zënë	do të kem/jem vënë
----------------------------	-----------------	----------------	--------------------	--------------------

38

Mënyra Lidhore

Tipi i foljes	kam	jam	zë	vë
E tashme	të kem të kesh të ketë të kemi të keni të kenë	të jem të jesh të jetë të jemi të jeni të jenë	të zë të zësh të zërë të zëmë të zini të zënë	tëvë të vësh të vërë të vëmë të vini të vënë
E pakryer	të kisha	të isha	të zija/zihesha	të vija/vihesha
E kryer	të kem pasur	të kem qenë	të kem/jem zënë	të kem/jem vënë
E kryer e plotë	të kisha pasur	të kisha qenë	të kisha/isha zënë	të kisha/isha vënë

39

Mënyra habitore

Tipi i foljes	kam	jam	zë	Vë
E tashme	paskam paskë paska paskemi paskeni paskan	qenkam qenke qenka qenkemi qenkeni qenkan	u/zënkam u/zënke u/zënka u/zënkemi u/zënkeni u/zënkam	u/vënkam u/vënke u/vënka u/vënkemi u/vënkeni u /vënkam
E pakryer	paskështa paskëshë paskësh paskëshim paskëshit paskëshit	qenkështa qenkëshë qenkësh qenkëshim qenkëshit qenkëshin	u/zënkështa u/zënkëshë u/zënkësh u/zënkëshim u/zënkëshit u/zënkëshin	u/vënkështa u/vënkëshë u/vënkësh u/vënkëshim u/vënkëshit u/vënkëshin

³⁸ Fadil Sulejmani "Praktikumi i gjuhës shqipe", Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë 1981 f. 131

E kryer	paskam pasur	paskam qenë	paskam/qenkam zënë	paskam/qenkam vënë
E kryer e plotë	paskështa pasur	paskështa qenë	paskështa/qenkështa zënë	paskështa/qenkështa vënë

40

Mënyra dëshirore

Tipi i foljes	kam	jam	zë	Vë
E tashme	paça paç pastë paçim paçi paçin	qofsha qofsh qoftë qofshim qofshi qofshin	u/zënça u/zënç u/zëntë u/zënçim u/zençi u/zënçin	u/vënça u/vënç u/vëntë u/vënçim u/vënçi u/vënçin
E kryer	paça pasur	paça qenë	paça/qofsha zënë	paça/qofsha vënë

41

Mënyra kushtore

Tipi i foljes	kam	jam	zë	vë	nxë	Lë
E tashme	do të kisha	do të isha	do të zija/zihesha	do të vija/vihesha	do të nxija	do të lija
E kryer	do të kisha pasur	do të kisha qenë	do të kisha /isha zënë	do të kisha/isha vënë	do të kisha nxënë	do të kisha lënë

42

⁴⁰ Fadil Sulejmani "Praktikumi i gjuhës shqipe", Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë 1981 f.139

⁴¹ Po aty

⁴² Fadil Sulejmani "Praktikumi i gjuhës shqipe", Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë 1981 f.147

Mënyra Urdhërore

Tipi i foljes	kam	jam	zë	vë	nxë	lë
E tashme	ki kini	ji jini	zër/zihu zini/zihuni	vër/vihu vini/vihuni	nxër nxirni	lër lini

Format e pashtjelluara të foljes

Përcjellorja

Tipi i foljes	kam	jam	zë	vë	nxë	lë
Koha e tashme	duke pasur	duke qenë	duke (u) zënë	duke (u) vënë	duke nxënë	duke lënë
Koha e kryer	duke pasë pasur	duke pasë qenë	duke pasë/ zënë	duke pasë vënë	duke pasë nxënë	duke pasë lënë

Paskajorja

Tipi i foljes	kam	jam	zë	vë	nxë	lë
E pohimit	për të pasur	për të qenë	për të (t'u) zënë	për të (t'u) vënë	për të nxënë	për të lënë
E mohimit	pa pasur	pa qenë	pa (u) zënë	pa (u) vënë	pa nxënë	pa lënë

Pjesorja

<i>Pjesore</i>	pasur	qënë	zënë	vënë	nxënë	lënë
----------------	-------	------	------	------	-------	------

⁴³ Fadil Sulejmani "Praktikumi i gjuhës shqipe", Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë 1981 f.147

Pjesët e pandryshueshme të ligjëratës

Siç dihet, pjesët e pandryshueshme të ligjëratës janë ndajfolja, parafjala, lidhëza, pjesëza dhe pathirrma.⁴⁴

Ndajfolja

Ndajfoljet rrinë kryesisht afër foljeve për të plotësuar më mirë kuptimin e tyre si *Rri shtremër e fol drejt* etj. Ndajfoljet e përdorura në gjuhën e sotme letrare shqipe janë tipash dhe formash të ndryshme si a) ndajfoljet e mënyrës: *kështu, ashtu, drejt, ëmbël, hutueshëm, pritur, barkas, barkazi, fluturimthi, përmendsh, malësorçe, përbri* etj b) ndajfoljet e kohës: *tash, sot, herët, pastaj, nesër, kurdoherë, përherë*, etj. c) ndajfoljet e vendit: *këtu, atje, andej, këtej, këndej, poshtë, prapa, mbrapa, më, pak, aq, fare, pakëz, fort, tejet* etj.⁴⁵

Parafjala

Siç dihet parafjalët vihen para emrash, para mbiemrash të emëruar, para përemrash dhe para numërorësh themelorë në një rasë të caktuar për të shprehur lidhjet e tyre sintaksore me fjalë të tjera në një fjali si *Punët e mëdha s'bëhen pa shokë; S'del gjëprej koprracit; Mendon për ne; Me njëlule s'del pranvera* etj. Parafjalët më të zakonshme në shqipen e sotme letrare janë parafjalë të thjeshta: *në, më, me, pa, mbi, për, nga, te, tek, nën, ndër, prej, ndaj, bri*; të përngjitura: *nëpër, përbri, ndërmjet, nëpërmjet, përmes, nëpërmes, kundër, përkundër, kundrejt, kundruall, përkundër, përpos* dhe lokucione: *për në, për te, prej nga, për nën, për nga, për kah* etj.⁴⁶

Lidhëza

Lidhëzat shërbejnë për të lidhur dy fjalë a togfjalësha në një fjali ose dy fjali në një periudhë si *Dardhadhe molla janë të ëmbla, kursekumbullat janë të tharta* etj. Vështruar në pikëpamjet drejtshkrimore, është me rëndësi për lidhëzat të dihet se disa sosh shkruhen në formë të përngjitur, ndërsa disa të tjera në formë të ndarë, në formë lokucionesh të ndryshme.⁴⁷

Pjesëza

Pjesëzat janë fjalë që shprehin nuancë kuptimore plotësuese të një fjale, të një togfjalëshi, të një fjalie të tërë ose sajojnë forma gramatikore të foljeve. Ato janë të llojeve të ndryshme si *ndoshta, mbase, nuk, ja, qe, a, e, le, duke, aty-aty* etj. Vështruar nga ana drejtshkrimore disa pjesëza

⁴⁴ Fadil Sulejmani "Praktikumi i gjuhës shqipe", Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë 1981 f.153

⁴⁵ Fadil Sulejmani "Praktikumi i gjuhës shqipe", Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë 1981 f.155

⁴⁶ Fadil Sulejmani "Praktikumi i gjuhës shqipe", Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë 1981 f.159

⁴⁷ Fadil Sulejmani "Praktikumi i gjuhës shqipe", Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë 1981 f.163

shkruhen me -ë në fund, disa tjera pa -ë, ndërsa sipas strukturës gramatikore ato mund të jenë fjalë të thjeshta, të përngjitura dhe lokucione.⁴⁸

Pasthirrma

Pasthirrmat janë fjalë që shërbejnë për të shprehur ndjenjat e folësit a për të tërhequr vëmendjen e të tjerëve. Varësisht nga kjo, pasthirrmat mund të jenë emocionale dhe urdhërore. Pasthirrmat emocionale shprehin ndjenja të ndryshme të folësit: a) gëzim, kënaqësi, entuziazëm, admirim: *o!, oh!, oho!, ohoho!, të lumtë!, urra!, uha!* etj. b) pakënaqësi, keqardhje, dëshpërim, mërzitje: *a!, ah!, e!, of!, oi!, ufl!, vaj!, haj!.haj!* etj. c) frikë, tmerr: *kuku!, bubu!, bobo!, obobo!, o bre!, mjera unë e mjera! olele!* etj.; ç) mospërfillje, përbuzje: *ama!, ahu!, eh!, ohu!, ptu!, jazëk!, punë e madhe!, hajt bre!* etj.⁴⁹

E mbsuame e krështererë e Lekë Matrëngës

Vepërza e Lekë Matrëngës “E mbsuame e krështererë” është libri më i vjetër i njohur deri më tash i të folmeve arbëreshe të Italisë e i dialektit toskë në përgjithësi dhe i dyti, pas “Mesharit” të Buzukut, i mbarë gjuhës shqipe. Si shumë vepra të tjera të vjetra të shqipes, ashtu edhe vepërza e Matrëngës, përkrah përmbajtja, është kryekëput religjioze. Si e tillë ajo nuk ka vlerë të posaçme letrare, por rëndësia e saj qëndron kryesisht në studimin historik të gjuhës dhe të letërsisë shqipe në përgjithësi dhe të dialektit toskë e të të folmeve arbëreshe të Italisë në veçanti. Njohja e vepërzes së Matrëngës, së bashku me “Mesharin” e Buzukut, si libra më të moçëm, që pasqyrojnë gjendjen e vjetër të gjuhës sonë, kanë rëndësi të madhe për historinë e shkrimit, për fonetikën e për morfologjinë historike, për leksikologjinë, për ortografinë, për dialektologjinë dhe për letërsinë shqipe në përgjithësi dhe të dialektit toskë e të folmeve arbëreshe të Italisë në veçanti. Njohja e vepërzes së Matrëngës, së bashku me “Mesharin” e Buzukut si libra më të moçëm, që pasqyrojnë gjendjen e vjetër të gjuhës sonë, kanë rëndësi të madhe posaçme edhe për rikonstrukcionin e shqipes që nga shekulli XVI.⁵⁰

⁴⁸ Fadil Sulejmani “Praktikumi i gjuhës shqipe”, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë 1981 f.167

⁴⁹ Fadil Sulejmani “Praktikumi i gjuhës shqipe”, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë 1981 f.169

⁵⁰ Fadil Sulejmani “E mbsuame e krështererë e Lekë Matrëngës”, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 1979, f.7

Shënime për jetën e autorit

Familja e Lekë Matrëngës është një ndër familjet më të vjetra arbëreshe që zunë vend në Hora. Ajo madje ka pasur edhe stemën e vet, që është parë dhe është përshkruar nga Z. Skiroi. Në gjirin e kësaj familjeje u lind L. Matrënga Brenda vjetëve 1563-1567 në Hora të Arbreshëve pranë Palermos në Sicili. Të dhënat biografike për Lekë Matrëngen përgjithësisht janë shumë të varfëra, të pasigurta dhe jo të plota. Lekë Matrënga duhet të jetë lindur rreth viteve 1563-67. Në Kolegj ka hyrë më vitin 1587, vit ky i kthimit të tij në vendlindje. Ky është kolegji Grek i Shën Athanasit, që e themeloi në atë kohë, kryesisht më vitin 1577, Papa Gregori XIII me qëllime të caktuara propagandistike fetare, që t'u shërbejë mbarë shqiptarëve e grekëve të vendosur nëpër krahinat e ndryshme të Italisë jugore.⁵¹

Vepërza

Në historinë e filologjisë shqipe deri me tash dihet se vepra e parë letrare e shkruar me shqipen e të folmeve arbëreshe të Italisë dhe të dialektit toskë në tërësi është katekizmi i Lekë Matrëngës, që mban titullin shqip “E mbsuame e krështerë” dhe italisht “Dotrina crisstiana”. Nga vet emri “katekizëm” kuptohet se ky është një libërth me brendi religjioze, të cilin më 1952 Matrënga e përktheu lirisht nga italishtja në shqip prej një teksti spanjoll të priftit P. Landsema.⁵² Lidhur me trajtën e jashtme, dorëshkrimi i parë dhe i dytë janë të shkruar me faqe dy shtyllash (dsh1-89/dsh2-38 sosh) kurse dorëshkrimi i tretë me një shtyllë (29 sosh). Dorëshkrimi i parë (nr. 9) me një vëllim prej 1-48 fl. Hapet me Fletëkushtesën në gjuhën italiane, që kap një madhësi prej 1-4 fl., pastaj menjehere vjen në fl. 5. Kënga e përshpirtshme shqip-latinisht dhe prej fl. 8-48 (fl. 6 e 7 mungojnë, në vend të tyre ndeshen fletët e bardha të shprazta) çilet teksti i katekizmit, përkatësisht dsh1 me titullin italisht-shqip të pasuar dorëmenjë nga ai shqip si “Dotrina Christiana che deve saper ogni fedelo christiano” dhe shqip “Embsuame e chraexterae ciaie prepsn të die gjithë i pipstem i chraextee” – E mbsuame e krështerë që prepsn të die gjithë i pistepsn i krështee, që në përkthim shqip do të tingullonte: “E mësuar e krishterë që duhet të dijë çdo besimtar i krishterë”. Të theksojmë se në këtë dorëshkrim ndeshen krah për krah që të dy tekstet: edhe italisht edhe shqip.⁵³ Dorëshkrimi i dytë (nr.10) nis nga fleta 52 e shkon deri te ajo 72. Ky dorëshkrim ka një kaligrafi tjetër, që ndryshon shumë nga ajo e dsh1. Menjëherënë ballë duket titulli i shkruar vetëm në italisht me germa të mëdha shtypi si DOTRINA CHRISTIANA COMPOSTA DAL R. P. Dottor, LEDESMA DELLA COMPAGNIA DI GIESU. Gjithashtu vetëm në italisht është dhënë me shkronja të vogla cursive shtesa: Tradotta di lingua Italiana

⁵¹ Fadil Sulejmani “E mbsuame e krështerë e Lekë Matrëngës”, Instituti Albanologjik i Prishtinës , Prishtinë 1979 f.15

⁵² Fadil Sulejmani “E mbsuame e krështerë e Lekë Matrëngës”, Instituti Albanologjik i Prishtinës , Prishtinë 1979 f.18

⁵³ Fadil Sulejmani “E mbsuame e krështerë e Lekë Matrëngës”, Instituti Albanologjik i Prishtinës , Prishtinë 1979 f.19

nell'Albanese per Luca Matranga alunno del Collegio Greco in Roma.⁵⁴ Dorëshkrimi i tretë (nr.11) me një madhësi prej 73-86 fl, ka një kaligrafi që ndryshon më shumë nga ajo e dsh1 dhe dsh2, por në të dy gjuhët: më parë. Ky dorëshkrim e ka në krye titullin e njejtë me atë të dsh2, por në të dy gjuhët: më parë shqip e pastaj italisht. Sidoqoftë, njësoj si dhe dsh2, nis me Ndjesen e papës dhe vazhdon teksti me titullin shqip të dorëshkrimit gjithashtu vetëm në gjuhën shqipe dhe i ndarë në kapituj të sipas predikimeve të besimit katolik, duke u mbyllur me Engjullin e tinëzot.⁵⁵ Ndërmjet dsh1, dsh2 dhe dsh3, që përfaqëson edhe kopjen e shtypur, paraqiten edhe ndryshime të shumta e të mëdha grafike, fonetike, morfologjike, sintaksore, leksikore madje edhe brendiore. a) Ndryshimet grafike. Në përgjithësi në dsh1 shihet prirja kah përdorimi i dy tri apo katër shkronjave për të shfaqur një tingull të shqipes, që kopjistët në dsh2 dhe në dsh3 anojnë kah thjeshtësimi i tyre në njëshkronjësh.⁵⁶ b) ndryshimet fonetike në dsh2 dhe në dsh3 janë njëkohësisht trajta të çoroditura fjalësh që vijnë në kundërshtim të madh me rregullat e ligjet fonetike të gjuhës shqipe si thëhetë, shëmë, të umblë, të rëhesh etj. c) Ndryshimet sintaksore në dsh2 dhe në dsh3 janë: ishtë ndë gjithë vendet ma përpara thëhetë se ishte ndrë qiellt tek fanarosetë shejtevet, si janë shëmë të shënmërisë konsimë etj. ç) Ndryshimet sintaksore në dsh2 dhe dsh3 janë: ishtë ndrë qiellt tek fanarosetë shejtevet, si janë shëmë të shënmërisë konismë etj. d) ndryshimet leksikore. Në dsh2 dhe në dsh3 kopjistët anojnë kah përdorimi i fjalëve greke në vend të atyre shqipe.⁵⁷ dh) Ndryshimet brendiore. Në radhë të parë në dsh2 dhe dsh3 përkundër dsh1 brendia është e ndarë në kapituj sipas predikimeve e leksioneve të besimit. Këta kapituj janë të pajisur dhe me nga një mbishkrim. Pasuset Engjëlli i tinëzot dhe Ndjesa e papës të dsh2 dhe dsh3 kopjistët ia kanë shtuar në fund dsh1.⁵⁸

Fletëkushtesa

Siç është vënë në dukje edhe më parë, dsh1 e ka në ballë një letër kushtimi në gjuhën italiane, e cila fillon nga f.1 e mbaron në faqen 4. Kjo letër nuk dihet se kujt i kushtohet, sepse Matrënga nuk ka shënuar në të kurrfarë titulli as emri të njeriut që ia shkruan. Mirëpo megjithëse pa ndonjë adresë të caktuar të personit, nga vetë brendia e saj dhe rrethanat e kohës, nën të cilat u shkrua ajo, kuptohet fare qartë se Letërkushtesa i drejtohet Zotëri Ludovikut II të Torres në atë kohë vendlindja e Matrëngës, Hora e t'Arbreshëvet, së bashku me kolonitë tjera arbëreshe

⁵⁴ Fadil Sulejmani "E mbsuame e krështerë e Lekë Mëtrëngës", Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 1979 f.20-21.

⁵⁵ Po aty.

⁵⁶ Fadil Sulejmani "E mbsuame e krështerë e Lekë Matrëngës", Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 1979 f.25

⁵⁷ Fadil Sulejmani "E mbsuame e krështerë e Lekë Matrëngës", Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 1979 f.26

⁵⁸ Fadil Sulejmani "E mbsuame e krështerë e Lekë Matrëngës", Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 1979 f.27

të sicilisë i takonte dioqezës së Montrealit, respektivisht ishte feud i juridiksionit kishtar të drejtuar nga kryepeshkopët e këtij shteti.⁵⁹

Grafia

Nësaje të studimeve të bëra në të tri dorëshkrimet e katekizmit të Matrëngës, albanologë të ndryshëm si M. La Piana, S. Riza, M. Shambra e të tjerë kanë arritur në një përfundim se dorëshkrimi autentik i Matrëngës, siç u theksua edhe më lart, është ai dsh1, kurse dsh2 dhe dsh3 janë kopjime nga duar të tjera. Pas analizës së bërë në këto tri dorëshkrime edhe nga ana jonë është nxjerrë i njëjti konkluzion sa i përket dorëshkrimit burimor. Gjithashtu nuk dihet nëse Matrënga e ka pasur në dorë “Mesharin” e Buzukut (1555) ose ndonjë vepër tjetër shqipe të botuar apo në dorëshkrim, që mund të kenë ndikuar në hartimin e grafisë së vet, e cila në shumë pika përputhet mjaft me atë të Buzukut. Fjala vjen, paraqitja e gjatësisë së zanoreve me anë të geminacionit të tyre si *saa, jee*, etj. Përdorimi i grafive *i* për *i* dhe *j*; *u* për *udhe v*; *l* për *l* dh *ll*; *gn* për *nj*; *c* e *ch* për *k*; spër *s*, *z*, e *sh*; cpër *ç* sa takime tjera, jo vetëm grafike, por edhe fonetike, morfologjike, sintaksore etj.⁶⁰

Gjuha

Gjuha e L. Matrëngës s’është gjë tjetër veçse gjuha e vjetër popullore shqipe e variantit dialektor toskë, përkatësisht e folmja e vjetër italo-arbëreshe në përgjithësi dhe nëndialekti i kolonive shqiptare të Sicilisë në veçanti. Ajo është e folmja e vendlindjes së Matrëngës—e Horës t’Arbreshëvet, që në thelb ende ruhet si e tillë. Në mënyrë të veçantë këtu vlen të theksohet se kjo e folme e katundit të Matrëngës dallohet nga të folmet tjera italo-arbëreshe përkrah veçantia fonetike e shqiptimit të laterals *ll* herë si *g*, herë si *h*, e herë si *r* dhe të velares *g* si *h*. bashkëtingëllorja *ll* shqiptohet si *g(gh)* gjithnjë kur ndodhet përpara një zanoreje ose në mes zanoresh si *vgha-vlla, mogha-molla, kjioghi-qielli*,..... “*vesh kjiheghin me miegugha*”-*vesh qiellin me mjegulla* etj. si *h* sidomos kur ka përpara një bashkëzanore ose një ësi *mahkoj-mallkoj, uthuh(ë)-uthull* etj. dhe si *r* kur gjendet në fund të fjalës si *gjer(ë)-gjellë* etj. Kurse bashkëtingëllorja *g* shqiptohet si *h* sidomos kur ndodhet në fillim të fjalës para zanoreve si *gare-hare*.⁶¹

Fonetika

Meqenëse dsh1 është dorëshkrimi origjinal i vetë përthimit të Matrëngës, kurse dsh2 dhe dsh3, që përfaqëson kopjen e shtypur, janë kopjime të dsh1 nga kopjistët, të cilët lëshuan shumë gabime gjuhësore, që e bëjnë të pasigurt materialin për një studim real të gjuhës së Matrëngës,

⁵⁹ Fadil Sulejmani “E mbsuame e krështerë e Lekë Matrëngës”, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 1979 f.30

⁶⁰ Fadil Sulejmani “E mbsuame e krështerë e Lekë Matrëngës”, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 1979 f.44-45

⁶¹ Fadil Sulejmani “E mbsuame e krështerë e Lekë Matrëngës”, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 1979 f.63

mu për këtë arsye edhe fonetika e gjuhës së këtij autori do të jepet e vështruar sipas dsh1, por duke mos lënë anash as krahasimet e tij me dsh2 dhe me dsh3, përkatësisht duke dhënë edhe ndryshimet gjuhësore-fonetike nga dsh2 dhe dsh3. Në dsh1, përkatësisht autograf të matrëngës shihet fare mirë se ortografia e gjuhës së këtij autori është në përgjithësi ortografi fonetike përkundër dsh2 dhe dsh3. Në dsh1 përkatësisht në dorëshkrimin autograf të Matrëngës shihet fare mirë se ortografia e gjuhës së këtij autori është në përgjithësi ortografi fonetike përkundër dsh2 dhe dsh3, ku kopjistët anojnë kah përdorimi i një ortografie etimologjike.⁶²

Vokalet

Sistemi vokalik i gjuhës së L. Matrëngës fonetiki përbëhet prej gjashtë zanoresh, që grafikisht pos zanoresh *ë*, janë të njëjta me ato të shqipes së sotme. Këto janë *a, e, i, o, u, odhe ë (ae)*. Pra, përkundër shqipes së sotme letrare vokalizmit të Matrëngës i mungon edhe fonetiki e grafikisht zanorja *y*, sikurse edhe të folmeve arbëreshe të Italisë. Siç u pa më lartë dhe siç do të shihet edhe më tej, në vend të këtij tingulli ndeshet e përdorur vazhdimisht zanorja *i*. Shikuar edhe nga aspekti ortografik, këto zanore të gjuhës së Matrëngës nuk paraqesin ndonjë ndryshim të madh nga ato të gjuhës të bashkohore letrare shqipe. Veçmas nga kjo pikëpamje ato përputhen më shumë me zanoret e sotme të dialektit toskë. Marrë në përgjithësi, më tepër ndryshime paraqiten te zanoret *a, e, i* dhe *ë*, kurse më pak tek ato *u* dhe *o* në krahasim me shqipen e sotme letrare.⁶³

Theksi

Përsa i takon theksit në gjuhën e Matrëngës nuk mund të bëhet fjalë në kuptimin e sotëm të tij, për shkak se atë ai s'e paraqet në mënyrën grafike ashtu siç e njohim sot ne. Për këtë qëllim Matrënga përdor disa mjete të tjera fonetike: rrokjet e theksuara të një fjalie në fund në mes apo në ballë të saj qofshim, cilësohen njëkohësisht nga gjatësia e zanoreve të dyzuara grafikisht si *fuqij (13) dhèe (20), prâa (10) bèekimit, të bëëmëvet (17), èej zot (14)* etj. Në lidhje me këtë është karakteristike të përmendet se Matrënga çdo fjalë, pa marrë parasysh funksionin leksiko-gramatikor të saj, d.m.th se a është ajo kryesore apo shërbyese dhe numrin e rrokjeve pjesëmarrëse në përbërjen strukturore të saj, e shënon me një farë theksi që grafikisht nuk ngjan me ndonjë lloj të theksave të sotëm, por më fort me një presje të drejtë.⁶⁴

⁶² Fadil Sulejmani "E mbsuame e krështerë e Lekë Matrëngës", Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 1979 f.64-65

⁶³ Fadil Sulejmani "E mbsuame e krështerë e Lekë Matrëngës", Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 1979 f.66

⁶⁴ Fadil Sulejmani "E mbsuame e krështerë e Lekë Matrëngës", Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 1979 f.82

Dukuritë fonetike

Në gjuhën e L. Matrëngës dukuritë fonetike i gjejmë të zhvilluara si me vokale ashtu edhe me konsonante. Ndër to më të dendura janë asimilimi, elizioni dhe rotacizmi. i ndeshim edhe dukuritë fonetike që kanë të bëjnë me rënien dhe shtimin e tingujve të një fjale.

Asimilimi

Nëgjuhën e Matrëngës pasqyrohet edhe dukuria fonetike e asimilimit. Ndeshet kryesisht asimilimi i plotë në kontakt i grupeve bashkëtingëllore *-tnë, -llnë, -ljnë, e-rnë*. Ai përfshin sidomos fushën e emrave që dalin me temë okluzivin *t* dhe me sonantet *l, ll* e *r*. Procesi ndodh në rasën kallëzore të shquar njejës në mes fundoreve tematike të emrave përkatës dhe mbaresënyjës rasore *-në: a)-tnë>në: isus krishnë (11)< krishtnë: krishnnë: krishnë*.⁶⁵

Elizioni

Meqë gjuha e L. Matrëngës qëndron më afër gjuhës së folur, elizioni si dukuri fonetike e gjuhës popullore ndeshet mjaft edhe në ortografinë e këtij autori. Si në shqipen e sotme popullore ashtu edhe në gjuhën e Matrëngës elidohet më së tepërmi zanorja fundore *ë* e një fjale para zanores fillestare të fjalës tjetër. Por përkundër, zbatimit të sotëm grafik të apostrofit, në vend të zanores së zhdukur, është karakteristike të theksohet se Matrënga, mungesën e zanores së eliduar, nuk e shënon me kurrfarëapostrofi, që grafikisht mungon fare te ai. Madje Matrënga shkon aq larg sa e shkruan edhe fjalën e zanores së eliduar së bashku me fjalën pasuese, duke e paraqitur kështu tërë sintagmën e një fjalie të vetme, si përkrah forma, ashtu edhe përkrah theksi si *t'et* në vend të *të et*.⁶⁶

Rotacizmi

Si dukuri e vjetër fonetike e dialektit toskë rotacizmi ndeshet që nga dokumentet e para të gjuhës shqipe. Nga kjo kuptohet se atë e gjejmë edhe në sistemin fonetik të gjuhës së Matrëngës, që i përket këtij dialekti si *bëri* (16), *emërinë*(26), *urdhër* (32), *kurora* (47) etj. Kështu me radhë të gjitha ato fjalë, që sot në dialektin toskë dhe në shqipen letrare dalin *-n-* të rotacizuarintervokalik, përdoren në këtë gjendje edhe te Matrënga, që do të thotë se *n*-ja ndërzanore ndeshet çdokund e rotacizuar ne *r* te ky autor i parë toskë⁶⁷.

⁶⁵ Fadil Sulejmani "E mbsuame e krështerë e Lekë Matrëngës", Instituti Albanologjik i Prishtinës , Prishtinë 1979 f.91

⁶⁶ Fadil Sulejmani "E mbsuame e krështerë e Lekë Matrëngës", Instituti Albanologjik i Prishtinës , Prishtinë 1979 f.92-93

⁶⁷ Fadil Sulejmani "E mbsuame e krështerë e Lekë Matrëngës", Instituti Albanologjik i Prishtinës , Prishtinë 1979 f.94

Ortografia

Vështruar nga ky aspekt gjuhën e autorit tonë mund të thuhet që në fillim se ta ai mbizotëron në përgjithësi praktika ortografike e shkrimit të fjalëve të patheksuara proklitike ndarazi nga të theksuarat përkatëse si *è të shërbejnë*(10), *u zdorq ndër pisët të trenëtë dittë*(12). Anasjelltas, fjalët e patheksuara enklitike Matrënga i shkruan gjithmonë së bashku me të theksuarat përkatëse si *ëmëna* (20), *ndëljena* (20), *dëftona* (24), *të keqi bën* (34) etj.⁶⁸

Morfologjia

Njësoj si grafia, ortografia e fonetika edhe morfologjia është vështruar sipas dorëshkrimit origjinal të vetë përkthimit të Matrëngës, d.m.th. sipas dsh1, duke dhënë njëkohësisht edhe ndryshimet ekzistuese në mes dsh2 dhe dsh3, megjithëse ato në morfologji nuk janë aq të mëdha sa në grafi e fonetikë. Në krahasim me këto pjesë të përmendura të gjuhës së Matrëngës, morfologjia është shumë më stabile edhe brenda vetë dsh1.⁶⁹

Emri

Emrin në libërthin e L. Matrëngës e gjejmë të përdorur në të gjitha kategoritë e tij gramatikore: në të tria gjinitë, në të dy numrat, në të gjitha rasat edhe në të dy trajtat e njëjësit dhe shumësit. Po ashtu aty hasim në emra të përveçëm dhe të përgjithshëm, në ata të sendit dhe të kuptimit.⁷⁰

Mbiemri

Në krahasim me gjendjen e sotme të shqipes, ku mbizotëron prirja e përdorimit të mbiemrit pas emrit, në gjuhën e Matrëngës ndeshen mjaft raste të kundërta, d.m.th të përdorimit të mbiemrit para emrit si *ishtë i vërtet inëzot e i vërtetë njeri* (8), *di të mbëdhenj mistirje* (9), *e të pasosmesë gjellë* (12) etj. Përdorimi i këtyre mbiemrave dhe të tjerëve si këta para emrave në gjuhën e Lekë Matrëngës, ashtu siç na paraqitet, është e vështirë të shpjegohet te të gjithë me arsyen e emfazës apo me ruajtjen e një gjendjeje më të hershme të shqipes, sepse historia e kësaj gjuhe ende ruhet ende s'e ka sqaruar se cila topikë e mbiemrit mbizotëronte në krye të herës ajo para apo ajo pas emrit. Por, me sa duket, në këtë pikëpamje te një pjesë e mirë e tyre, kemi të bëjmë më tepër me çështjen e përkthimit të tekstit , ku italishtja, që cilësohet me prirjen e paravendosjes së mbiemrit,

⁶⁸ Fadil Sulejmani "E mbsuame e krështerë e Lekë Matrëngës", Instituti Albanologjik i Prishtinës , Prishtinë 1979 f.99

⁶⁹ Fadil Sulejmani "E mbsuame e krështerë e Lekë Matrëngës", Instituti Albanologjik i Prishtinës , Prishtinë 1979 f.105

⁷⁰ Po aty.

mund të ketë ndikuar në këtë drejtim. D.m.th se sintagma italiane me mbiemër përpara emrit do të jenë përkthyer kështu drejtpërdrejt nga Matrënga edhe në gjuhën shqipe.⁷¹

Përemrat

Në vepërzën e Matrëngës ndeshen të përdorur më shumë përemrat vetorë, pronorë, dëftorë e të pacaktuar, kurse më pak përemrat pyetës e fare pak përemrat lidhorë.⁷²

Nyja

Në sistemin nyjor të gjuhës së autorit tonë ndeshen të përdorura që të tria palët e nyjave: nyjat e përparme *i, e, të (së)*; nyjat e prapme *-i, -u, -a, -të, -t*, dhe nyjat e trajtës së pashquar *një-nji e çado*.

Numërori

Si shumë kategori të tjera leksike-gramatikore edhe numërorët në përdorimin e tyre janë të kushtëzuar nga brendia religjioze dhe vëllimi i katekizmit, i cili nuk përfshin një numër aq të mjaftueshëm fjalësh dhe formash të tyre sa për të parë në tërësi gjuhën e Matrëngës, përkatësisht shqipen e dialektit toskë në kohën e këtij autori. Kështu, bie fjala, përdorimi i numërorëve, si themelorë, ashtu edhe rreshtorë është i kushtëzuar nga nevoja e numërimit të urdhëresave fetare, uratave, lejesave e ndalesave, lutjeve e faljeve etj. Varësisht nga kjo, në tekstin e Matrëngës ndeshen të përdorur numërorët themelorënjë (23), *di*, (9), *tre* (14), *katë* (10), *të pesë* (45), *shtatë* (31), *të tetë* (42), *të dhjetë* (31), *të të dimbëdhjetë* (12), *të pesë mbëdhjetë* (45), *katë zet* (48) dhe *një qin* (48), Numërorët themelorëgjashtë dhe nëntë nuk figurojnë kund veçse me shifra.⁷³

Folja

Sistemi foljor në vepërzën e Matrëngës nuk na del i plotë me të gjitha kategoritë, format dhe kuptimet gramatikore të foljes, si të mënyrës, të kohës, të vetës, të diatezës, të numrit etj. Fjala vjen, habitorja, kushtorja dhe paskajorja nuk ndeshen fare. Këtë të fundit, si do të shihet më tej, Matrënga e zëvendëson gjithnjë me lidhoren. Më së shumti haste dëftorja, kryesisht koha e tashme, e kryera e thjeshtë dhe e ardhmja e tashme; pastaj e kryera dhe me ndonjë shembull fare të rrallë e pakryera, e kryera e plotë, e kryera e thjeshtë dhe e ardhmja e tashme; pastaj e kryera dhe me ndonjë shembull fare rrallë edhe e pakryera, e kryera e plotë, e kryera e tejshtuar dhe e ardhmja e përparme. Te lidhorja përdoret kryesisht koha e tashme, një herë e kryera dhe nja dy

⁷¹ Fadil Sulejmani "E mbsuame e krështerë e Lekë Matrëngës", Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 1979 f.122

⁷² Fadil Sulejmani "E mbsuame e krështerë e Lekë Matrëngës", Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 1979 f.126

⁷³ Fadil Sulejmani "E mbsuame e krështerë e Lekë Matrëngës", Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 1979 f.151

herë e pakryera, kurse e kryera e plotë nuk takohet fare. Ndeshen dendur edhe urdhërorja, përcjellorja dhe pjesorja, por më rrallë dëshirorja. Nga kohët ndeshet më së shumti e tashmja, qoftë e dëftores, e lidhores apo e ndonjë mënyre tjetër. Diategmat janë të pranishme që të dyjat: veprorë dhe pësorë-vetvetore; po ashtu edhe numrat: njëjës e shumës por nga vetat mungon veta e dytë e numrit shumës, me përjashtim të një rasti të vetëm, në të tashmen e lidhores.⁷⁴

Ndajfolja

Si shumë pjesë të ligjëratës edhe ndajfoljet e përdorura në vepërzen e Matrëngës janë mjaft të rralla. Kjo nuk do të thotë se në vepërzen e Matrëngës kanë munguar shumë ndajfolje në të folmen arbëreshe të Sicilisë, por ai s'ka pasur rastin që t'i përdorë të gjitha ndajfoljet që i ka shqipja e sotme letrare. Nga ato që ndeshen tek autori ynë janë këto: 1) *Ndajfoljet e kohës* si a) *përpara e pastaj*: *përpara* ndë nomt të vjetër e *pastaj* krishti inëzot I mbajti ndë t ërit (31), b) *nani*: ...thuj *nani* të të këqia vet...(33), c) *njize*: pse mënjize duamë të vdesëmë se ti ftesnjëmë, d) *parë*: *mëë parëqardesetë* për hir të tinëzot e pastaj për të prepsurat...(19); 2) *Ndajfoljet e vendit* si a) *ashtu*: e *ashtu* jemi bërë bilj të tinëzot (37); 3) *Ndajfoljet e mëyrës* si a) *ashtu*: e *ashtu* jemi bilj të tinëzot⁴ *Ndajfoljet e sasisësi* a) *mëë*: e çëmëë(16) b) *shumë*: të jesëmë me *shumëvlavie* (39), *Ndajfoljet e mohimit* si a) *nukë* / *nëkë*: *Nukë bën* (34) b) *mos*: *mos* kujtojsh (31), c) Se *sishtë* (s'ishtë) njeri nesh çë mkatëskaa (s'kaa) etj. 6. *Ndajfoljet pyetësesi* a) të vendit: *ku ishtë inëzot* (21); b) të shkakut: pse p.sh *psee* bëënë c) të mënyrës: *Si* do të duash mirë fqinjënë..? etj. Vështruar për nga stuktura, si ndajfolje të përngjitura na del ndajfolja *përpara*, që është formuar nga *parafjala për* dhe ndajfolja *para*, kurse si lokucione ndajfoljore i ndeshim këto fjalë: *me durim* (45), *me urtë*(38), *me lodrë*(31), *shumë herë*(33), *një herë*(32)etj. Si të durojsh *me durim* pirasmotë (45) etj. Në shkallën krahasore i gjejmë ndajfoljet *mëë njize*(28), *mëë parë* (19).⁷⁵

Parafjala

Nga parafjalët e përdorura në tekstin e Matrëngës ndeshen këto: 1) *Parafjalët e rasës emërore* si a) *kaha*: *kaha* hiri i tinëzot (38), *kaha* shejta triadhë (15), *kaha* na vinjënë (19); 2. *Parafjalët e rasës kallzore* si a) *ndë* : *ndëbotë* (11), b) *ndënë*: psoj *ndënë* pont pilanë (11); c) *ndrëgjithë* graat (21); ç) *mbë*: *mbështrat* (26), *mbi*: *mbi* gjithë shërbiset (28); *për* shpirtit e *për* kurmit (21), ë) *paa*: *paa*të bëmet të mira (29), tue vaturë *paa* të mbëshuarë të shpirtit (40); 3. *Parafjalët e rasës*

⁷⁴ Fadil Sulejmani "E mbsuame e krështerë e Lekë Matrëngës", Instituti Albanologjik i Prishtinës , Prishtinë 1979 f.152

⁷⁵ Fadil Sulejmani "E mbsuame e krështerë e Lekë Matrëngës", Instituti Albanologjik i Prishtinës , Prishtinë 1979 f.177

*rrjedhore, përkatësisht dhanore, ku disa ndajfolje përdoren në funksion të parafjalëve si dhe sot p.sh disa ndajfolje të vendit : përpara meje (30) pasbeekimit (39), pas këti të zbuami (24) etj.*⁷⁶

Lidhëza

Njësoj si ndajfoljet dhe parafjalët, edhe lidhëzat e përdorura në vepërzën e Matrëngës janë të pakta. Fjala vjen, nga lidhëzat e ndeshura te ky autor janë lidhëzat bashkrënditëse: 1. *Lidhëzat shtuese* si a) *e*: është ai që bëri e qeverisn dheenë e qiellëe gjithë zotëron (13), b) *edhe*: ju bënj edhe ndeer (26), *edhe* thom të tjerë...(28) etj. 2. *Lidhëzat ndasoresi* a) o...(o). 3. *Lidhëzat kundërshtoresi* a) *por*: jo zot por një vetëmë...(23); b) *njish*, c) *ma*. 4) *Lidhëzat përmbyllëse* si a) *praa* të shërbejnë tënëzonë ndë këtë gjellëpraa te shohë. c) *adha*: shpejto *adha* ti... 1. *Lidhëzat filluesesi*: a) *se*, b) që ndlëgon ti se është krishti. 2. *Lidhëzat shkakore* si a) *se*: lumtë ata që janë të butëse ata kanë të shohënë tënëzonë (42) 3. *Lidhëzat vendoresi* a) *tek*: ishte ndrë qiell *tek* fanerosetë shejtevet (21), 5. *Lidhëzat lejore* si a) *saado*: jo zot se *saadotë* jeenë tri faqe një i vetëmë inëzot (14) 6. *Lidhëzat rrjedhore* si a) *aqëi* fuqishëm *aqëi* urti *aqëi* miri *saa* i ati ..., 7. *Lidhëzat mënyrore-krahasoresi* a) *si*: Sina që jemi bëerë mbi shemullit e të glarëe të ti...(15). b) *ashtu si*: kloftë bëerë thelima jote *ashtu* ndrë qiellt si ndë dhe.⁷⁷

Pjesëza

Po ashtu edhe pjesëzat Mëtranga nuk pati rastin që t'i përdorë të gjitha. Nga ato që ndeshen në vepërzën e tij janë: 1) *Pjesëza e pohimit eej* si M. Ati është inëzot (?) Im. *Eej* zot, M. I biri është inëzot (?); 2. *Pjesëza e mohimit jo* si *jozot* (23); 3. *Pjesëzat trajtë formuese tue, të* dhe vetëm njëherë haset pjesëza e ngurosur foljore *do* si *tue* gjumuarë e *tue klaarë* (24 etj.) tëruhesh mishit (32 etj.) dhe *do* të duash (29); 4. *Pjesëzat veçuese vetëm dhe e mëë parëpër* të sotmen *sidomos* si *jo zot por njëvetëmëçë* është ndrë qiellt.. etj.⁷⁸

Pasthirrma

Pasthirrmat e ndeshura në vepërzën e Matrëngës janëo,*hënjëdhe amin* p.sh ...o e paraponesme *oe* lipsurëo e ëmblë virgjërë shënmëri parakales për nee shejta ëmë e tinëzot ... (24) etj.⁷⁹

Themelimi i Universitetit të Tetovës

Më 4 qershor të vitit 1994, në sallën e Kuvendit komunal të Tetovës u mbajt Kuvendi themelues i Universitetit të Tetovës. Për rëndësinë e këtij Kuvendi kanë shkruar deri më sot shumë studiues, por me këtë rast do ta citoj Rektorin e parë të Universitetit të Tetovës, tani më të ndjerë, Prof. Dr.

⁷⁶ Fadil Sulejmani "E mbsuame e krështerë e Lekë Matrëngës", Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 1979 f. 178

⁷⁷ Fadil Sulejmani "E mbsuame e krështerë e Lekë Matrëngës", Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 1979 f. 179

⁷⁸ Fadil Sulejmani "E mbsuame e krështerë e Lekë Matrëngës", Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 1979 f. 180

⁷⁹ Po aty

Fadil Sulejmani, në atë kohë kryetar i Këshillit për themelimin e Universitetit të Tetovës, i cili në mbledhjen e mbajtur të këtij Këshilli, ku e paraqiti raportin e punës së deriatëhershme, më 27 gusht 1994, mes tjerash deklaroi: „Iniciativa e hapjes së Universitetit me mësim në gjuhën shqipe në Maqedoni u konkretizua më 4 qershor, kur u mbajt Kuvendi për themelimin e Universitetit nga intelektualët shqiptarë të rangut universitar. Duke hyrë në lokalet e kësaj godine për të mbajtur këtë mbledhje (bëhet fjalë për Kuvendin komunal të Tetovës. Shënimi im), për herë të parë në historinë e shqiptarëve të Maqedonisë u hapën dyert e Universitetit shqiptar dhe kështu kemi marrë çelësat e fatit në duart tona, të historisë, të traditës e të gjuhës tonë.⁸⁰(Ismail Arslani, Universiteti hapet me çdo kusht, Rilindja, Tiranë, 28 gusht 1994). Shqiptarët e Maqedonisë edhe më herët kanë bërë përpjekje për realizimin e të drejtës për arsimim në gjuhën amtare, dhe në mënyrë të veçantë në arsimin e lartë. Por, iniciativa më serioze ishin dy, iniciativa e Unionit të Inteligjencies Shqiptare për hapjen e Fakultetit Pedagogjik me mësim në gjuhën shqipe, me seli në Shkup, në kuadër të Universitetit të Shkupit, dhe iniciativa nga nënkryetari i Kuvendit komunal të Tetovës, Liman Kurtishi, për hapjen e një institucioni të arsimit të lartë me mësim në gjuhën shqipe, në nivel të Komunës së Tetovës. Në takimin e përbashkët të subjekteve politike dhe jopolitike shqiptare në Maqedoni, të mbajtur më 20 gusht të vitit 1993, në Shkup, u formua Komisioni Amë për hapjen e Fakultetit Pedagogjik me mësim në gjuhën shqipe, i cili pas miratimit të dokumenteve të nevojshme, mbajtjes së disa takimeve dhe zhvillimit të shumë bisedimeve me organet përkatëse të pushtetit të atëhershëm nuk arriti të gjejë zgjidhje për realizimi e kësaj iniciative. Ngjashëm ndodhi edhe me iniciativën tjetër nga Kuvendi komunal i Tetovës. Kërkesa zyrtare drejtuar organeve përkatëse të pushtetit nuk hasi në mirëkuptim nga organet e pushtetit dhe nuk rezultoi me asnjë efekt pozitiv. Iniciativa për hapjen e Universitetit të Tetovës nuk ishte vazhdimësi e asnjërës nga këto iniciativa, edhe pse janë realizuar disa takime pune, sidomos me Komisionin Amë për hapjen e Fakultetit Pedagogjik me mësim në gjuhën shqipe. Të gjitha takimet janë realizuar në frymën e bashkëpunimit, të afrimit dhe homogjenizimit të faktorit shqiptar, për arritjen e rezultateve sa më të plota. Për qasjen ndryshe ndaj kësaj çështje e Kryesisë së Bashkësisë Kulturore Shqiptare në Maqedoni dëshmojnë faktet dhe dokumentet e shumta, si: Platforma për hapjen e Universitetit Shqiptar në Maqedoni (janar 1994), Komunikata e BKSH-së (2 mars 1994), Shkresa me Konkluzionet e Kryesisë së BKSH-së drejtuar Komisionit Amë për hapjen e Fakultetit Pedagogjik me mësim në gjuhën shqipe, etj, Ndërsa përpara mbajtjes së Kuvendit u hartua Lista e kuadrit të mundshëm që do të mbajë mësim në këtë Universitet, u organizuan dhjetëra takime, me përfaqësues të subjekteve politike, drejtues të komunave, drejtorë të shkollave të mesme dhe profesorë të dalluar, me intelektualë dhe veprimtarë të tjerë. Hapja e Universitetit Shqiptar në Maqedoni ka qenë ide autoktone dhe iniciativë plotësisht e ndryshme nga të tjerat, sepse koncepti, mënyra e veprimit, taktika dhe strategjia, si dhe e tërë filozofia e veprimit ishte prurje e re e Bashkësisë Kulturore Shqiptare në Maqedoni. Në asnjë dokument të miratuar dhe të publikuar gjatë fundit të

⁸⁰<http://www.tetovasot.com/2017/06/universiteti-i-tetoves-vater-e-perndritur-e-rilindjes-kulturore-te-shqiptareve-ne-maqedoni/>

vitit 1993 dhe fillimit të vitit 1994, dhe në asnjë rast nuk është përmendur parashtrimi i ndonjë kërkesë drejtuar organeve përkatëse të pushtetit të atëhershëm në Republikën e Maqedonisë, duke pasur parasysh zbrazëtinë ligjore në atë kohë, sepse këtë të drejtë e garantonte Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, neni 44, 45 dhe 46, por nuk ishte rregulluar kjo çështje me ligj përkatës. E gjithë ideja ka qenë „marrja e fatit në duart tona”, themelimi i Universitetit, zgjedhja e organeve drejtuese të tij, njoftimi opinionit të brendshëm dhe të jashtëm, „futja në lojë”, e subjekteve politike, kuvendeve komunale dhe përfaqësuesve shqiptarë në organet e pushtetit të asaj kohe, sigurimin e mbështetjes për realizimin e këtij projekti, realizimi i punëve përgatitore, sigurimi i kuadrit të nevojshëm, përgatitja e planeve dhe programeve mësimore, sigurimi i hapësirave të nevojshme për organizimin e mësimin dhe punët e administratës, sigurimi i financave të nevojshme dhe fillimi me punë i Universitetit të Tetovës në vitin akademik 1994/1995. Çdo gjë ka qenë e planifikuar mirë dhe me saktësinë më madhe, me analiza të hollësishme dhe me maturi. Janë studiuar, korniza ligjore, baza kushtetuese, mbështetja në aktet ndërkombëtare për realizimin e të drejtës për arsimim në gjuhën amtare në nivel universitar, dhe janë ndërmarrë aktivitetet e nevojshme për ngritjen e kësaj iniciative në kohën më të përshtatshme, sipas vlerësimit tonë. Muaji qershor nuk ka qenë i zgjedhur rastësisht, as vendi dhe pjesëmarrësit. Në këtë kohë Republika e Maqedonisë ndodhej përpara tri operacioneve të rëndësishme në nivel shtetëror, edhe atë: 1. Organizimi i regjistrimit të popullsisë dhe pasurive, me mbikëqyrje ndërkombëtare, 2. Mbajtja e zgjedhjeve parlamentare në vjeshtë të po këtij viti, 3. Ndërmarrja e masave urgjente për mbajtjen e stabilitetit ekonomik të vendit, pas vendosjes së embargos ekonomike nga fqinji jugor, Republika e Greqisë, si dhe rrethana të tjera të cilat nuk u jepnin mundësi organeve të pushtetit të ndërmarrin fushatë represive ndaj kësaj iniciative dhe bartësve të saj. Më vonë u dëshmuua se, edhe përkundër kërcënimeve për anulimin e mbajtjes së Kuvendit themelues të Universitetit të Tetovës (plot tri orë u zhvilluan punimet e tij), edhe atë, në Kuvendin komunal të Tetovës, brenda institucionit shtetëror. Ishte proceduar e rregullt dhe vigjilenca e organizatorit që nuk la hapësirë për ndërhyrjen e organeve të rendit. Ndërsa, shkaqet për rastet e mëvonshme, me krijimin e tensioneve, ndërhyrjen e organeve policore, brutalitetin e policisë, rrahjet, vrasjet, maltretimet dhe burgosjet e bartësve të kësaj iniciative, duhet t'i kërkojmë edhe në lojalitetin e skajshëm të përfaqësuesve shqiptarë në Parlamentin dhe Qeverinë e atëhershme të Republikës së Maqedonisë. Pas përgatitjeve të nevojshme, më 4 qershor 1994 u mbajt Kuvendi themelues i Universitetit të Tetovës, siç edhe ishte planifikuar. Më 4 qershor, nga orët e hershme të mëngjesit rritej numri i pjesëmarrësve, delegatëve të ftuar të këtij Kuvendi, që vinin nga të gjitha qytetet shqiptare në Maqedoni, nga Prishtina dhe viset tjera, në qytetin e Tetovës, ku do të mbahej ky Kuvend me rëndësi historike për të ardhmen tonë.⁸¹

⁸¹<http://www.tetovasot.com/2017/06/universiteti-i-tetoves-vater-e-perndritur-e-rilindjes-kulturore-te-shqiptareve-ne-maqedoni/>

Kjo ishte edhe një mundësi e unifikimit të qëndrimeve për mbrojtjen e të drejtave tona të ligjshme, meqë deri më sot nuk ishte organizuar asnjë takim i këtij niveli, ku pa dallim të përkatësisë politike dhe bindjeve të tjera, të sillëshin vendime kaq me peshë për një çështje me interes kombëtar. Pritja e delegatëve u bë në restorantin e pronarëve Naim dhe Gjylimsere Kasapi, përballë Kuvendit komunal të Tetovës. U mbledhën bashkë në një vend dhe, me një qëllim madhor në zemër dhe mendje, përfaqësues të partive politike, të shoqatave dhe asociacioneve të tjera, përfaqësues të pushtetit qendror dhe lokal, intelektualë me tituj shkencorë, profesorë universitetesh, veteranë të arsimit, biznesmenë dhe dashamirë të tjerë.⁸² Para fillimit të punimeve të Kuvendit, duke mbajtur përgjegjësi si organizator dhe me qëllim që punimet e këtij Kuvendi të kenë rrjedhë të suksesshme dhe të sillen vendime të duhura, u mbajt një mbledhje konsultative me bartësit kryesorë të kësaj iniciative, për t'u njoftuar me rendin e ditës, përgatitjet e nevojshme që ishin bërë, planet dhe detyrat që do t'u besohen organeve të cilat pritej të zgjedhen nga ky Kuvend, me qëllim të mbarëvajtjes së punëve dhe fillimit të punës së Universiteti në vitin akademik 1994/95. Kjo mbledhje u mbajt para fillimit të punimeve të Kuvendit, në sallën e vogël të Kuvendit komunal të Tetovës, me fillim në orën 10:00. Në këtë mbledhje morën pjesë 11 vetë, mes tyre edhe Dr. Fadil Sulejmani, Dr. Murtezan Ismaili, Dr. Ali Vishko, Dr. Masar Kodra, Dr. Rahmi Tuda dhe anëtarë të Kryesisë së BKSH-së. Qëllimi i kësaj mbledhje përgatitore ishte njoftimi me qëndrimet e Kryesisë së BKSH-së për mbajtjen nën kontroll të situatës pas tensionimit të shkaktuar nga organet drejtuese të Kuvendit komunal të Tetovës dhe kërcënimeve nga organet e Ministrisë së Punëve të Brendshme, për hapjen dhe drejtimin e punimeve të Kuvendit, ruajtjen e gjakftohtësisë nëse do të ketë tone polemizuese, mënyrën e emërimit të organeve drejtuese, komisioneve dhe trupave të tjera, si dhe përbërjen e tyre, për Kryesinë e përkohshme të Universitetit, Komisionet amë të 6 fakulteteve të parapara të Universitetit, nënshkrimin e Deklaratës për hapjen e Universitetit të Tetovës, nga delegatët e Kuvendit, e cila do të miratohej për ta njoftuar opinionin e brendshëm dhe të jashtëm etj. Në kohën e paraparë, në orën 11:00, në sallën solemne të Kuvendit komunal të Tetovës, i filloi punimet Kuvendi për themelimin e Universitetit të Tetovës. Me fjalë rasti, punimet e këtij Kuvendi i hapi Abdulla Mehmeti, në cilësinë e Kryetarit të BKSH, në organizimin e së cilës u bënë ftesat dhe u organizua ky Kuvend. Në këtë Kuvend morën pjesë 116 delegatë, nga të gjitha viset shqiptare në Maqedoni, përfaqësues të partive politike, asociacioneve jopolitike shqiptare, përfaqësues të komunave, të Komunës së Tetovës, Gostivarit dhe Dibrës, kurse pjesën më të madhe të delegatëve e përbënin intelektualë me tituj shkencorë. Fadil Sulejmani përkujtoi se në Maqedoni me kohë është i pranishëm një potencial i mirë i intelektualëve të profileve të ndryshme me arsim sipëror të cilët disponojnë tituj magistrash dhe doktorësh të shkencave. Tash të evidencuar mbi 150 e së shpejti ky numër do të jetë edhe mbi 200, që është një bazë e mirë për nismën e një institucioni të lartë siç synojmë. Shkollimi i lartë dhe sipëror i shqiptarëve në Maqedoni nuk duhet t'i pengojë askujt, shqiptarët kanë të drejtë të shkollohen deri në fund, që u

⁸²<http://www.tetovasot.com/2017/06/universiteti-i-tetoves-vater-e-perndritur-e-rilindjes-kulturore-te-shqiptareve-ne-maqedoni/>

është mohuar deri tash, dhe se gjithë kjo do të shërbejë edhe si urë afrimi mes dy popujve. Nuk kemi rrugëdalje tjetër pa mos i realizuar të gjitha të drejtat kombëtare. Ai tha se universiteti në gjuhën shqipe në Maqedoni në fillim do të fillojë me punë me gjashtë fakultete, sa kemi kushte tash, ndërsa për këtë vendim do t'i informojmë forumet përkatëse dhe faktorin ndërkombëtar duke kërkuar edhe përkrahjen e tyre. Në rrethanat e krijuara në Maqedoni, pas shpërbërjes së Jugosllavisë, kur u vunë kufijtë e paligjshëm brenda territoreve tona etnike dhe u bë i pamundshëm studimi i shqiptarëve nga Maqedonia në Universitetin e Prishtinës, e më gjerë, si dhe të bojkotuar nga universitetet e Maqedonisë, që i financojnë edhe shqiptarët, intelektualët shqiptarë të rangut universitar nga Maqedonia e panë të arsyeshme që të mbajnë Kuvendin për ngritjen e iniciativës për themelimin e Universitetit me mësim në gjuhën shqipe në Maqedoni. Nga fakti se në këtë republikë mijëra shqiptarë me shkollë të mesme e kanë të pamundshme t'i vazhdojnë studimet universitare, është nevojë e zhvillimit të natyrshëm e civilizues, marrja e këtij vendimi historik e human për ngritjen e kuadrove arsimore e shkencore të shqiptarëve në Maqedoni në gjuhën e tyre amtare. Për këtë shkak, më 4 qershor 1994, në Tetovë u mbajt Kuvendi i intelektualëve shqiptarë të rangut universitar nga Maqedonia dhe mori këtë vendim: themelohet Universiteti në gjuhën shqipe në Maqedoni, me seli në Tetovë. U zgjodh Kryesia për themelimin e Universitetit, në përbërje prej tre anëtarësh dhe këta janë: Dr. Fadil Sulejmani, Dr. Agni Dika dhe Dr. Murtezan Ismaili (Ky organ i përkohshëm për udhëheqjen e Universitetit u zgjodh me aklamacion, ndërsa organizatori i këtij Kuvendi, ka sjellë Vendim përkatës për këtë. Ky Vendim është pjesë e Procesverbalit nga Kuvendi themelues i Universitetit të Tetovës. Shënimi im). U zgjodh njëkohësisht Këshilli themelues (amë) në përbërje prej 18 anëtarëve, nga tre anëtarë për gjashtë fakultetet që do të themelohen, të cilët janë: Fakulteti Filologjik, Dr. Mahmud Hysa, Dr. Imail Ahmedi dhe Mr. Nexhibe Palloshi; Fakulteti Filozofik, Dr. Masar Kodra, Dr. Ali Vishko dhe Dr. Avzi Mustafa; Fakulteti Juridik – Ekonomik, Mr. Musli Halimi, Mr. Abdulla Aliu dhe Mr. Petrit Pollozhani; Fakulteti Pedagogjik, Dr. Tahir Zajazi, Mr. Rahim Ganiu dhe Dr. Abdirauf Pruthi (Për këtë çështje vetëm është diskutuar, por nuk është sjellë Vendim, siç thuhet këtu, për arsye të sqaruara në vazhdim të këtij shkrimi. Shënimi im); Fakulteti Teologjik, Dr. Feti Mediu, Mr. Bari Aliu dhe Ef. Sulejman Rexhepi; dhe Fakulteti i Arteve, Adem Kastrati, Miftar Memeti dhe Zijadin Ismaili. Universiteti e fillon punën në vitin shkollor 1994-1995. Selia e Universitetit do të jetë në qytetin e Tetovës.⁸³

⁸³<http://www.tetovasot.com/2017/06/universiteti-i-tetoves-vater-e-perndritur-e-rilindjes-kulturore-te-shqiptareve-ne-maqedoni/>

Kërkoheh nga kuvendet komunale të Tetovës, Gostivarit dhe Dibrës, si dhe nga përfaqësuesit tanë politik në Parlamentin dhe Qeverinë e Maqedonisë, të marrin përsipër sjelljen e aktvendimit për themelimin e Universitetit me mësim në gjuhën shqipe. Pasi që Deklarata u aprovua me duartrokitje, Kuvendi i përfundoi punimet, ndërsa organet e zgjedhura mbajtën takimin e vet të parë, që të konkretizohen dhe intensifikohen punët”.⁸⁴

⁸⁴<http://www.tetovasot.com/2017/06/universiteti-i-tetoves-vater-e-perndritur-e-rilindjes-kulturore-te-shqiptareve-ne-maqedoni/> Abdulla Mehmeti " Universiteti i Tetovës, vater e përndritur e rilindjes kulturore të shqiptarëve në Maqedoni", 04.6.2017

Përfundim

Fadil Sulejmani u lind në katundin Bozovcë të Malësisë së Tetovës, më 5.12.1940. Fadil Sulejmani njihet për guximin për të themeluar së bashku me kolegë të tij, Universitetin e Tetovës në gjuhën shqipe në Maqedoni, në vitin 1994; një institucion ky që u njoh nga qeveria maqedonase vetëm pas dhjetë vjetësh. Për shkak të veprimtarisë së tij në këtë institucion arsimor, në kohën kur autoritetet e quanin të paligjshëm, ai u dënua dhe qëndroi për një vit burg. Profesor Fadil Sulejmani më parë ka punuar në Universitetin e Prishtinës. Ai është autor i një sërë artikujsh dhe punimesh shkencore në fushën e gjuhësisë. Sulejmani për një kohë ishte edhe deputet në Parlamentin e Maqedonisë. Ndër veprat e tij më të rëndësishme janë: „E mbsuame e krështerë e Lekë Matrëngës”, një monografi për jetën dhe veprën e këtij autori arbëresh, Prishtinë 1979; rëndësia e të cilës qëndron në studimin historik të gjuhës shqipe. „Praktikumi i Gjuhës së Sotme Shqipe”, Prishtinë 1981, shikuar nga aspekti drejtshkrimor dhe drejtshqiptimor etj. Profesor Fadil Sulejmani ka dhënë kontribut të rëndësishëm në fushën e Fonetikës dhe të Drejtshkrimit, në fushën e Gramatikës etj.

Literatura

Fadil Sulejmani Praktikum i gjuhës shqipe, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i krahinës socialiste autonome të Kosovës, Prishtinë, 1981.

Fadil Sulejmani E mbsuame e krështerë e Lekë Matrëngës, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1979.

Burime nga Interneti

<https://shqipmedia.com/dy-vjet-pa-rektorin-e-pare-te-usht-se-prof-dr-fadil-sulejmani/>

Abdulla Mehmeti“ Dy vjet pa rektorin e parë të USHT-së, Prof. dr. Fadil Sulejmani”, 13.2.2015

<http://www.tetovasot.com/2017/06/universiteti-i-tetoves-vater-e-perndritur-e-rilindjes-kulturore-te-shqiptareve-ne-maqedoni/> Abdulla Mehmeti “ Universiteti i Tetovës, vatër e përndritur e rilindjes kulturore të shqiptarëve në Maqedoni”, 04.6.2017

Jetëshkrimi

Kaltrina Krelani lindi më 26.10.1992, ne qytetin e Gjakovës ku i mori njohuritë e para në Shkollën Fillore dhe të mesme të ulët “Mustafa Bakija”, të mesmen e kreu në Gjimnazin “Hajdar Dushi” , kurse studimet themelore të nivelit Bachelor i kreu në Universitetin e Gjakovës “Fehmi Agani” në fakultetin e Filologjisë të programit të Gjuhës Shqipe.